




Ambasciata d'Italia
Tirana



RAPORT I ANALIZËS SË ORIENTIMIT TË NXËNËSVE PËR KARRIERËN NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR



ASCAP

Tiranë 2022

Përgatitja e raportit "Analiza e orientimit të nxënësve për karrierën në arsimin parauniversitar" u realizua nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), me mbështetjen e UNICEF Shqipëri, në kuadër të projektit "Qëndro" të financuar nga Qeveria Italiane.

Opinionet dhe sugjerimet e paraqitura në këtë botim i përkasin hartuesve të dokumentit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht këndvështrimet e UNICEF.

Mbështetën dhe koordinuan procesin e përgatitjes së raportit:

- Gerti Janaqi
- Dorina Rapti
- Evis Mastori
- Albana Markja



© Copyright 2022. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për ASCAP dhe UNICEF, Tiranë, Shqipëri

Tiranë, Qershor 2022



TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	4
METODOLOGJIA E ANALIZËS	7
ETIKA E KËRKIMIT	12
1 ORIENTIMI PËR KARRIERËN DHE ZHVILLIMI I AFTËSIVE PËR JETËN	13
1.1 KONCEPTI DHE RËNDËSIA E ORIENTIMIT PËR KARRIERËN	14
1.2 POLITIKAT E BE-SË PËR ORIENTIMIN PËR KARRIERËN	17
1.3 ELEMENTËT E ORIENTIMIT PËR KARRIERËN	19
1.3.1 INFORMIMI PËR KARRIERËN	20
1.3.2 EDUKIMI PËR KARRIERËN	21
1.3.3 KËSHILLIMI PËR KARRIERËN	26
1.4 PARIME ETIKE TË ORIENTIMIT PËR KARRIERËN	28

2	ANALIZA E SITUATËS AKTUALE TË ORIENTIMIT PËR KARRIERËN NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR.....	29
2.1	EDUKIMI PËR KARRIERËN PËRMES KURRIKULËS DHE DOKUMENTEVE KURRIKULARE.....	30
2.1.1	KORNIZA KURRIKULARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR.....	31
2.2	ARSIMI BAZË: ANALIZA E DOKUMENTEVE KURRIKULARE PËR ARSIMIN FILLOR DHE ARSIMIN E MESËM TË ULËT.....	43
2.2.1	ANALIZA E PROGRAMEVE MËSIMORE TË ARSIMIT FILLOR DHE TË MESËM TË ULËT SIPAS FUSHAVE TË TË NXËNIT.....	54
2.3	ARSIMI I MESËM I LARTË: ANALIZA E DOKUMENTEVE KURRIKULARE PËR ARSIMIN E MESËM TË LARTË.....	68
2.3.1	ANALIZA E PROGRAMEVE MËSIMORE TË ARSIMIT TË MESËM TË LARTË SIPAS FUSHAVE TË TË NXËNIT.....	76
2.4	LEGJISLACIONI PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR DHE HAPËSIRAT QË SIGURON PËR ORIENTIMIN PËR KARRIERËN.....	87
2.5	PRAKTIKAT DHE PËRVOJAT PËR ORIENTIMIN E NXËNËSVE PËR KARRIERËN NË INSTITUCIONET ARSIMORE PARAUNIVERSITARE.....	90
2.5.1	TË DHËNA TË PËRGJITHSHME.....	92
2.5.2	GJETJE NGA TË DHËNAT E INSTITUCIONEVE ARSIMORE.....	93
3	GJETJE.....	101
4	REKOMANDIME.....	107
5	BIBLIOGRAFIA.....	112



HYRJE

Prioriteti kryesor i sistemit arsimor parauniversitar në Shqipëri është krijimi i kushteve dhe mundësive që nxënësit të ndërtojnë kompetenca, të zhvillohen në mënyrë të pavarur dhe gjithëpërfshirëse, për të përballuar me sukses sfidat e jetës dhe të tregut të punës.

Fëmijët, të rinjtë dhe nxënësit sot përballen me sfida në aspektin e të mësuarit, punësimit dhe kohezionit social. Përvojat sugjerojnë se performanca e suksesshme në shkollë, punë dhe jetë duhet të mbështetet nga një gamë e gjerë aftësish dhe vlerash, zhvillimi i të cilave duhet të nxitet nga sistemi arsimor. Arsimi është një mjet i fuqishëm për zhvillimin e aftësive për punësim dhe produktivitet. Politikat europiane e kanë vënë orientimin për karrierën në krye të agjendës së tyre dhe kjo qasje duhet të adaptohet nga vendet që aspirojnë të bëhen anëtarë të BE-së, përfshirë Shqipërinë.

Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026 dhe reformat e ndërmarra nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të lartë vendosin theksin në fuqizimin e fëmijëve dhe të rinjve me aftësitë e nevojshme që sigurojnë përmbushjen e tyre si individë, përmbushjen e përgjegjësive sociale dhe përgatitjen për tregun e punës.

Kurrikula e bazuar në kompetenca që zbatohet në arsimin bazë dhe të mesëm të lartë, synon t'u mundësojë nxënësve të zhvillojnë aftësitë e të nxënësve gjatë gjithë jetës

përmes lëndëve dhe fushave të të nxënit. Krahas rolit të rëndësishëm që kanë kurrikulat në këtë drejtim, **shkolla duhet të ofrojë një sërë mundësish dhe përvojash të larmishme dhe të pasura për zhvillimin e aftësive për jetën dhe për orientimin e nxënësve për karrierë dhe punësim, përtej lëndëve dhe fushave të të nxënit.** Kjo është e rëndësishme veçanërisht për nxënësit e moshës 13-15 (klasat 7-9) në arsimin e mesëm të ulët dhe të rinjtë e moshës 17-18 (klasat 11 dhe 12) në arsimin e mesëm të lartë, të cilët duhet të ndërtojnë rrugën drejt arsimit të vazhdueshëm, angazhimit në tregun e punës dhe të përcaktojnë drejtimet e tyre të karrierës.

Përpjekjet aktuale për të gjetur mënyra të reja për të mbështetur edukimin për karrierën janë pjesë e një shtytjeje më të madhe për sistemin arsimor për t'iu përgjigjur kërkesave të të mësuarit të shekullit të 21-të.

Për të gjitha arsyet e mësipërme, ASCAP angazhohet të mbështesë përmirësimin e aftësive për jetën dhe orientimin e nxënësve për karrierën përmes analizës së situatës së orientimit për karrierën, në arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të lartë.

Analiza ka si qëllim vlerësimin e situatës aktuale, në arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të lartë, në lidhje me orientimin e nxënësve për karrierën dhe zhvillimin e aftësive të tyre për menaxhimin e karrierës, fokusuar në tre blloqe kërkimi (komponentë):

1. Kurrikula dhe dokumentet kurrikulare

2. Legjislacioni për arsimin parauniversitar

3. Praktika dhe përvojat në institucionet arsimore

Kjo analizë tenton të mbërrijë në disa përfundime dhe mbi këtë bazë, të japë sugjerime lidhur me format dhe hapësirat e mundshme për realizimin e orientimit për karrierën në sistemin arsimor parauniversitar, si dhe të ofrojë rekomandime që lidhen me zhvillimin e kapaciteteve të shkollave dhe të burimeve njerëzore që e mundësojnë atë.

Gjetjet dhe rekomandimet që parashtron analiza, synojnë:

- të mbështesin zhvillimin e mëtejshëm të politikave arsimore dhe përmirësimin e praktikave shkollore për orientimin e nxënësve për karrierën;
- të orientojnë vendimmarrje që mbështeten në të dhëna;
- të nxitin dialogun mes aktorëve që përpiqen të përmirësojnë orientimin për karrierën në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.

METODOLOGJIA E ANALIZËS

Analiza e orientimit të nxënësve për karrierën vendos në fokus të kërkimit tri komponentë:

Komponenti 1: Edukimi për karrierën përmes kurrikulës dhe dokumenteve kurrikulare.

Komponenti 2: Legjislacioni për arsimin parauniversitar dhe hapësirat që siguron për orientimin për karrierën.

Komponenti 3: Praktikrat dhe përvojat e institucioneve arsimore për orientimin për karrierën .

Fokus kryesor i kërkimit është kurríkula në të gjithë vitet e shkollimit të arsimit bazë dhe të mesëm të lartë. Lupa e kërkimit është ndalur në listimin: *Sa*, *Si*, dhe *Ku* janë të pranishme konceptet dhe rezultatet e të nxënësve që mundësojnë dhe nxisin zhvillimin e aftësive të menaxhimit të karrierës dhe orientimin e nxënësve për karrierën.

Gjithashtu, kërkimi ndalet të hulumtojë sa e potencon shkolla edukimin për karrierën si koncept dhe si proces, sa ajo stimulon tek të rinjtë besimin, motivimin e progresit, forcën e mendimit dhe sipërmarrjes, dëshirën për të inspiruar dhe arritur.

Analiza e situatës së orientimit për karrierën përfshin tri nivelet e arsimit parauniversitar:

- Arsimi fillor (klasat 1-5).
- Arsimi i mesëm i ulët (klasat 6-9).
- Arsimi i mesëm i lartë (klasat 10-12).

Kjo analizë nuk përfshin arsimin profesional.

Për realizimin e saj janë përdorur metodat cilësore dhe sasiore të kërkimit.

A. Për **Komponentin 1: "Edukimi për karrierën përmes kurrikulës dhe dokumenteve kurrikulare"**, kërkimi zhvillohet mbi bazën e një liste konceptesh të ndërlidhura me orientimin për karrierën dhe zhvillimin e aftësive për jetën, të identifikuara nga grupi i punës i përfshirë në kërkim.

Koncepte kyç mbi të cilat zhvillohet kërkimi janë:

- *Karriera*
- *Orientim për karrierën*
- *Edukim për karrierën*
- *Informim për karrierën*
- *Këshillim për karrierën*
- *Aftësi për jetën/Kompetenca për të nxënin gjatë gjithë jetës*
- *Menaxhim i karrierës*
- *Profesion*
- *Punë/punësim*
- *Vetëorientim*
- *Përgjegjësi për veten dhe për të tjerët*
- *Vendimmarrje*

Këto koncepte kyç (të konsideruara si "big concepts") përfshijnë brenda vetes dhe shprehin ndërlidhjen me një sërë konceptesh më specifike të cilët janë mbajtur parasysh nga grupi i punës gjatë kryerjes së kërkimit.

Dokumentet kurrikulare mbi të cilat zhvillohet kërkimi janë:

- Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar (MAS, 2014);
- Kurrikula bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor (2014);
- Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të ulët, klasat 6-9 (2014);
- Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të lartë, klasat 10-12 (2016);
- Programet mësimore të arsimit bazë (arsimi fillor dhe i mesëm i ulët) sipas fushave të të nxënit/lëndëve dhe klasave:
 - *Fusha e të nxënit: Gjuhët dhe komunikimi (Gjuha shqipe, Gjuha e huaj)*
 - *Fusha e të nxënit: Matematikë*
 - *Fusha e të nxënit: Shkencat e natyrës (Fizikë, Kimi, Biologji).*
 - *Fusha e të nxënit: Shoqëria dhe mjedisi (Qytetari, Histori, Gjeografi)*
 - *Fusha e të nxënit: Teknologji dhe TIK (Teknologji, TIK)*
 - *Fusha e të nxënit: Edukim fizik, sporte dhe shëndeti*
 - *Fusha e të nxënit: Arte (Art pamor, Muzikë, Teatër, Kërcim)*
- Programet mësimore të arsimit të mesëm të lartë sipas fushave të të nxënit/lëndëve dhe klasave, për kurrikulën bërthamë dhe kurrikulën me zgjedhje:
 - *Fusha e të nxënit: Gjuhët dhe komunikimi (Gjuha shqipe, Letërsia, Gjuha e huaj)*
 - *Fusha e të nxënit: Matematikë*
 - *Fusha e të nxënit: Shkencat e natyrës (Fizikë, Kimi, Biologji).*
 - *Fusha e të nxënit: Shoqëria dhe mjedisi (Qytetari, Histori, Gjeografi, Ekonomi, Filozofi, Psikologji, Sociologji)*
 - *Fusha e të nxënit: Teknologji dhe TIK (Teknologji, TIK)*
 - *Fusha e të nxënit: Edukim fizik, sporte dhe shëndeti*
 - *Fusha e të nxënit: Arte*
 - *Modulet kurrikulare, lëndore dhe profesionale.*

Kërkimi bën objekt kompetencat kyç dhe ato lëndore. Analiza fokusohet tek prania/mospresencia e koncepteve që lidhen me orientimin për karrierën, dimensionin konceptual dhe dimensionin aplikativ si dhe fryma që përcjellin programet lëndore.

B. Për **Komponentin 2 “Legjislacioni për arsimin parauniversitar”** analiza fokusohet në identifikimin e hapësirave ligjore që mundëson dhe siguron legjislacioni për arsimin parauniversitar në lidhje me orientimin për karrierën dhe çështjet që lidhen me të.

Analiza përfshin:

- *Ligjin “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” Nr.69/2012, i ndryshuar.*
- *Rregulloren e funksionimit të institucioneve arsimore të arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë (Urdhër Nr.31, datë 28.01.2020).*
- *Urdhri për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet arsimore parauniversitare dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social (Urdhër Nr.313, datë 20.10.2020).*

C. Për **Komponentin 3 “Praktikat dhe përvojat e institucioneve arsimore për orientimin e nxënësve për karrierën”** analiza e situatës synoi mbledhjen e të dhënave për secilin institucion arsimor parauniversitar mbi bazën e disa treguesve të përcaktuar si dhe interpretimin e këtyre të dhënave.

Të dhënat u siguruan përmes pyetësorëve të aplikuar me drejtues të institucioneve arsimore të arsimit bazë dhe të mesëm të lartë, mësues kujdestarë dhe mësues të lëndëve të ndryshme, psikologë shkollorë dhe punonjës socialë.

Pyetësi iu dërgua për plotësim çdo institucioni arsimor parauniversitar përmes 52 Zyrave Arsimore dhe 4 Drejtorive Arsimore Rajonale, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP). Të dhënat e pyetësorit janë të vetëdeklaruar nga institucionet arsimore.

Popullata e synuar për plotësimin e pyetësorit përfshiu institucionet arsimore të arsimit bazë dhe arsimit të mesëm të lartë, të shpërndara në zona urbane dhe rurale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas profileve të mëposhtme:

- Shkollë 9-vjeçare (AF+AMU)
- Gjimnaz
- Shkollë e mesme e bashkuar
- Shkollë e mesme me drejtim të orientuar artistik
- Shkollë e mesme me drejtim të orientuar sportiv

Instrumenti u strukturua në mënyrë të tillë që përmes kërkesave/pohimeve në pjesën e parë të tij të grumbullonte të dhëna të përgjithshme në lidhje me numrin e shkollave, profilin e tyre, shpërndarjen në zona urbane dhe rurale etj; ndërsa duke filluar nga kërkesa/pohimi 7, pyetësori synoi të mbledhë të dhëna specifike për çështje të orientimit për karrierën në shkolla.

Të dhënat e mbledhura u përpunuan nga ana statistikore me paketën statistikore SPPSS.

Procesi i mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave synoi analizën e sa më shumë të dhënave në lidhje me këtë çështje. Këto të dhëna përbëjnë një bazë shumë të vlefshme për të gjitha ndërhyrjet dhe programet në vazhdim, dhe mund të shfrytëzohen nga të gjithë të interesuarit dhe kontribuesit në këtë program.

Raporti i analizës së të dhënave përfshin interpretime të gjetjeve në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe shtojcën të cilat përmbajnë të dhënat në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal. Të interesuarit për të dhëna dhe lexime të tjera në nivel më të ngushtë do të duhet ta konsultojnë më tej databazën e të dhënave e cila krijon shumë hapësirë për përpunime të mëtejshme. Databaza me të dhënat e mbledhura mund t'i shërbejë përdoruesve të interesuar për identifikimin e të dhënave të tjera të detajuara të vlefshme, në nivel rrethi dhe institucioni arsimor.

Etika e kërkimit

Kërkimi dhe analiza i referohet parimit të konfidencialitetit, paanshmërisë dhe parimit në funksion të së mirës së përbashkët. Ekspertët kanë përdorur gjuhën e analizës duke tejkeluar emra konkretë, njësi administrative që projektojnë kurrikulën, institucione që janë hartues apo zbatues të kurrikulave, si dhe duke shmangur gjuhën pezhorative dhe etiketime përgjatë analizës. Analiza është udhëhequr nga qëllimi i vetëm, t'i japë përgjigje pyetjeve që janë identifikuar në fillim të kërkimit, duke i shmangur parapëlqimet si edhe paragjykimet. Kësisoj analiza, i ka shpëtuar mjaftueshëm, vlerësimeve subjektive, si një ndër parimet etike që ndiqen përgjatë një analize të një natyre të tillë.



1 ORIENTIMI PËR KARRIERËN DHE ZHVILLIMI I AFTËSIVE PËR JETËN



1.1 Koncepti dhe rëndësia e orientimit për karrierën

Në kuptimin e ngushtë të termit, "karriera" përdoret për të përshkruar një profesion ose pozicion pune që një individ zgjedh dhe ndjek përgjatë jetës.

Në kuptimin e gjerë, "karriera" është rruga e individit gjatë arsimimit, punës dhe aspekteve të tjera të jetës.

Kuptimi për karrierën ka ndryshuar me kalimin e kohës.

Sipas fjalorit të Oxfordit, karriera është rruga e një individi ose progresi i tij përgjatë jetës (ose një pjese të saj). Përcaktimi i orientimit për karrierën (career guidance) nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) është: "shërbime që synojnë të mbështesin dhe ndihmojnë qytetarët e çdo moshe dhe në çdo moment të jetës së tyre, për të bërë zgjedhje lidhur me arsimin, trajnimin, zhvillimin profesional dhe punësimin si dhe për të menaxhuar karrierën e tyre"¹.

Edhe Bashkimi Europian, e përcakton orientimin për karrierën si: "një sërë aktivitete me qëllim mbështetjen e individëve për të menaxhuar karrierën e tyre dhe për të bërë zgjedhje lidhur me arsimin, trajnimin dhe punësimin bazuar në karakteristikat e tyre personale".²

Për efekt të zhvillimit të një kuptimi të përbashkët në funksion të analizës, ***me orientim për karrierën do të kuptojmë mbështetjen që u japim nxënësve për të qenë më të përgatitur në arritjen e vendimeve lidhur me arsimimin, formimin profesional apo karrierën, bazuar në njohjen e vetes, interesave, shkathtësive e aftësive të tyre, si dhe burimet dhe mundësitë e lidhura me to.***

¹ <http://vet.ge/wp-content/uploads/2013/10/Career-Guidance-Handbook-ENG.pdf>

² <https://www.cedefop.europa.eu/et/toolkits/vet-toolkit-tackling-early-leaving/intervention-approaches/guidance-supporting-youth-manage-their-careers>

Në kushtet e një tregu pune dinamik dhe të ekonomisë së bazuar në dije, qasja ndaj orientimit për karrierën po bëhet gjithnjë e më komplekse, dhe synimi i orientimit shtrihet përtej njohjes me profesionet dhe zhvillimin e aftësive të lidhura me to.

Pra, orientimi për karrierën si funksion në arsim duhet të merret me zhvillimin dhe rritjen individuale të nxënësve, duke synuar aftësimin e individëve për të marrë vendime në mënyrë autonome.

Orientimi për karrierën ka për qëllim mbështetjen e nxënësve për të realizuar jo vetëm mësimnxënien, por edhe për t'u pajisur me aftësi të nevojshme për të jetuar të pavarur, për

Në mënyrë të veçantë, orientimi për karrierën synon tek nxënësit:

- *Zhvillimin e vetëdijes lidhur me zgjedhjen e karrierës, duke identifikuar, vlerësuar dhe kuptuar interesat, vlerat, aftësitë dhe prirjet e tyre.*
- *Përhapjen e informacioneve edukative dhe profesionale për të ndihmuar nxënësit dhe familjet e tyre për planifikimin e karrierës, si dhe për të zhvilluar kuptimin e tyre mbi tregun e punës.*
- *Përzgjedhjen e drejtimit, profilin dhe praktikave mësimore që i përshtaten nxënësit, me qëllim gjetjen e punës më të përshtatshme në të ardhmen;*
- *Marrjen e përgjegjësisë për të zhvilluar planet e karrierës, arsimin, praktikave, punësimit;*
- *Përgatitjen për gjetjen e punësimit të përshtatshëm duke zhvilluar aftësi për kërkimin e vendeve të punës, aftësi për t'u prezantuar si kandidat punëkërkes, dhe aftësi për të kuptuar përshtatjen mes aftësive të veta dhe kërkesave të pozicioneve e punëdhënësve të ndryshëm;*
- *Fitimin e përvojës përmes aktiviteteve shkollore, praktikave profesionale, vizitave në biznese, bashkëpunimit me shkollat e tjera, etj.*
- *Përdorimin e teknologjisë për të përmirësuar procesin e zhvillimit të karrierës.*
- *Përgatitjen për të menaxhuar karrierën e tyre pas certifikimit dhe/ose diplomimit.*

të vendosur për karrierën e tyre dhe për t'u përballur me tregun e punës.

Pra, orientimi për karrierën si funksion në arsim duhet të merret me zhvillimin dhe rritjen individuale të nxënësve, duke synuar aftësimin e individëve për të marrë vendime në mënyrë autonome.

Orientimi për karrierën në tërësinë e tij trajton disa probleme që lidhen jo vetëm me nxënësin por edhe me familjen e tij, si edhe mjedisin social ku ai vepron, sikurse parashtrohen më poshtë:

- ✚ Së pari, përmes orientimit për karrierën mund të tejkalohen tensionet në familje që lidhen me përfundimin e klasës së 9-të dhe zgjedhjen e shkollimit të mëtejshëm: arsim profesional apo i përgjithshëm, drejtimet, profilet etj.
- ✚ Së dyti, orientimi shërben për të kapërcyer problemin e informacionit të pakët apo të papërshtatshëm për nxënësit lidhur me mundësitë për arsim dhe tregun e punës.
- ✚ Së treti, orientimi për karrierën gjithashtu lehtëson problemin e mungesës së ndërgjegjësimit për profesionet, veçoritë e tyre, shtigjet e karrierës dhe nivelin e pagave në tregun e punës.
- ✚ Së katërti, shpesh aftësitë për të kërkuar në tregun e punës dhe për t'u profilizuar janë të kufizuara, ndaj orientimi vjen në ndihmë për të kapërcyer këtë mangësi.
- ✚ Së fundmi, përmes orientimit për karrierën lehtësohet edhe çështja e mungesës së vendimmarrjes për të ardhmen, në rast të braktisjes së shkollës.

Njohja e kontributit të orientimit për karrierën në nivelin individual, ekonomik e shoqëror, e ka kthyer atë në një pjesë thelbësore të arsimit duke i përgatitur nxënësit për të kaluar me sukses nga shkolla drejt një shtegu karriere të ardhshme.

1.2 Politikat e BE-së për orientimin për karrierën

Në ditët e sotme bota e punës është duke ndryshuar shumë shpejt, për shkak të ndryshimeve të shpejta teknologjike, ekonomike, politike dhe sociale. Politikat europiane synojnë të ndërtojnë një prioritet konkurrues të ekonomisë së BE-së, ekonominë e bazuar në dije. Një ekonomi e tillë është e rëndësishme për nxitjen e qytetarëve për të rritur në maksimum përdorimin e burimeve të tyre njerëzore. Orientimi për karrierën është një nga mekanizmat e rëndësishëm për stimulimin e zhvillimit të potencialit njerëzor. Politikat europiane e kanë vendosur orientimin për karrierën në krye të agjendës së tyre dhe kjo qasje duhet adaptuar edhe nga shtetet që aspirojnë të bëhen anëtare të BE-së, përfshirë Shqipërinë.

Në periudhën 2002-2005, Komisioni Europian në bashkëpunim me institucionet e tjera ndërkombëtare bëri disa studime me synimin për të zbuluar nëse shërbimet e orientimit për karrierën në shtetet anëtare të BE-së, janë të përgatitura për sfidat e së ardhmes. Të dhënat kanë treguar se duhet të bëhen hapa të mëtejshëm madhorë: zhvillim më i shpejtë i shërbimeve, cilësi më e mirë e tyre, sisteme më të mira për trajnimin e praktikuesve të orientimit për karrierën dhe zhvillimi i politikave të koordinuara për orientimin për karrierën.

Rezultatet e këtyre studimeve rritën ndërgjegjësimin mes politikbërësve se orientimi për karrierën do të jetë efektiv dhe do t'i arrijë qëllimet e veta nëse përkrahet nga një politikë e qartë dhe burime financiare të mjaftueshme.

Për këtë arsye, politikbërësit e futën orientimin për karrierën mes përparësive në dokumentin e politikës në nivel të BE-së dhe të shteteve anëtare. Në maj të vitit 2004, Këshilli miratoi Rezolutën për Fuqizimin e Politikave, Sistemeve dhe Praktikave në fushën e orientimit për karrierën në Europë. Orientimi për karrierë u bë një element i rëndësishëm i mësimin gjatë gjithë jetës. Rezoluta u rekomandon, në veçanti shteteve anëtare, të

zhvillojnë “teknika efektive mësimdhënieje, me synim përkrahjen e të mësuarit efektiv të rrugëve arsimore dhe të karrierës”.

1.3 Elementët e orientimit për karrierën

Orientimi për karrierën si një term gjithëpërfshirës përbëhet nga dy elementë kryesorë: *edukimi për karrierën, dhe këshillimi për karrierën.*

Të dy këta elementë përfshijnë *informimin për karrierën*, si një element i tretë i orientimit të nxënësve për karrierën.

EDUKIMI PËR KARRIERËN

Edukimi për karrierën është pjesë e kurrikulës së shkollës i cili mundëson që nxënësit të mësojnë rreth botës së punës dhe të zhvillojnë aftësi për të menaxhuar karrierën përmes procesit të të nxënit dhe aktiviteteve të tjera që sigurojnë lidhjen me botën e punës.



KËSHILLIMI PËR KARRIERËN

Këshillimi për karrierën përqendrohet në trajtimin dhe kapërcimin e sfidave që ka individ dhe siguron këshillim specifik për vendimmarrje që lidhen me karrierën. Realizohet si këshillim individual apo në grupe të vogla dhe ka një qasje më shumë psikologjike.



INFORMIMI PËR KARRIERËN

Informimi për karrierën përfshin informacionin për tregun e punës rreth: kurseve të kualifikimit, programeve të studimit, vendeve të punës dhe drejtimeve të mundshme të karrierës. Informacioni mund të jetë i shtypur (publikime/broshura, dosje, lista informacioni, fletëpalosje etj.) ose të shpërndahet në formë elektronike (në kompjuter ose internet). Sot gjithnjë e më shumë informacioni ofrohet dhe sigurohet online (web-based).

1.3.1 Informimi për karrierën

Informimi për karrierën përfshin informacionin për tregun e punës (gjithmonë e më tepër në ditët e sotme ofrohet online) rreth: kurseve të kualifikimit, programeve të studimit, vendeve të punës dhe drejtimeve të mundshme të karrierës.

Informacioni për karrierën:

- mund të ofrohet nga mësuesit/këshilluesit e karrierës.
- duhet të jetë një përshtatje apo interpretim i informacionit të tregut të punës.
- duhet të jetë i thjeshtë për t'u kuptuar nga nxënësit që kërkojnë informacione, këshilla dhe udhëzime për karrierën.
- jepet në varësi të nevojës/vendimmarrjes që ka nxënësi.

Informacioni për karrierën bazohet në informacionin e tregut të punës, por nuk mund t'i serviret nxënësve siç gjendet i publikuar, pasi është kompleks dhe në format jo të kuptueshëm për ta. Për nxënësit, informacioni për karrierën duhet të jetë sa më i thjeshtë dhe tërheqës.

Informacioni i tregut të punës për orientimin në karrierë duhet të përmbushë kriteret e cilësisë si më poshtë:

KRITERI	SHpjegimi
Saktësia	Informacioni duhet të jetë i saktë. Çdo informacion i ri duhet të verifikohet imtësisht.
Plotësia	Informacioni duhet të jetë sa më i plotë të jetë e mundur.
Aktualiteti	Informacioni duhet të përfshijë të dhënat më të fundit. Të dhënat duhet të përditësohen periodikisht.
Rëndësia	Informacioni duhet të jetë i rëndësishëm për çështjet e zhvillimit të karrierës së nxënësve dhe duhet të përshtatet me nevojat e grupeve të ndryshme të përdoruesve.

Pamja tërheqëse	Informacioni duhet të paraqitet në një format vizual të përshtatshëm dhe tërheqës, duke përfshirë elemente si: infografikat, tabelat, pikurat, ikonat, tekste të formatuara.
Lehtësisht i aksesueshëm dhe i përdorshëm	Informacioni duhet të marrë në konsideratë aftësitë e ndryshme të përdoruesve. Duhet të jetë i aksesueshëm lehtësisht.
Paanshmëria	Informacioni i ofruar duhet të jetë në përputhje me interesin e përdoruesit dhe nuk duhet të ndikohet nga ofruesit, interesat institucionale dhe financuese. Ai nuk duhet të jetë diskriminues në bazë të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, klasës sociale, kualifikimeve ose aftësisë.
Autoriteti	Informacioni duhet të vijë nga burime të besueshme.
Krahasueshmëria	Të dhënat e siguruara duhet të jenë të krahasueshme gjatë kohës.

1.3.2 Edukimi për karrierën

Edukimi për karrierën i referohet aktiviteteve që zhvillon shkolla për të ndihmuar nxënësit të qartësojnë qëllimet e tyre për karrierë, të kuptojnë botën e punës dhe të mësimin, dhe të zhvillojnë aftësitë për menaxhimin e karrierës.

Zhvillimi i karrierës është njëherësh kompleks dhe unik për secilin individ, duke sjellë një grup aftësish, vlerash, interesash dhe përvojash të veçanta në procesin e planifikimit dhe menaxhimit të karrierës së tyre.


Qëllimi i edukimit për karrierën është që nxënësit të mësojnë për veten, rreth mundësive të edukimit dhe botës së punës, ndërsa qëllimi i shërbimeve të tjera (këshillimit) është t'i zbatojë këto njohuri dhe aftësi në situatën personale të nxënësit.

Elementë të tillë në programet arsimore nxisin reflektimin kritik rreth botës së punës, ndërgjegjësimin për mundësitë e të nxënësve dhe të trajnimit, njohjes më të thellë të vetes si

dhe të atyre që referohen si "aftësi të menaxhimit të karrierës" që shpesh mësohen përmes përvojës.

Programe të fuqishme të edukimit për karrierën sigurojnë mundësi të nxëni që ndërlidhen fuqishëm me punën, shkollën, komunitetin, përmes platformave digjitale dhe mediave sociale. Të nxënit për karrierën dhe eksplorimi i karrierës përfshin, por shkon dhe përtej, sigurimit të informacionit rreth arsimimit të mëtejshëm dhe punësimit, dhe mund të realizohet në grup, sikurse dhe si këshillim individual përmes intervistave.

Programet e edukimit për karrierën u vijnë në ndihmë nxënësve të mësojnë rreth botës së punës, të fitojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime që janë të nevojshme për t'u orientuar për drejtimet e ndryshme gjatë jetës. Shkolla i përgatit nxënësit për botën e punës duke i socializuar ato me vlera të veçanta, të tilla si vetëdisiplina, përpikmëria, puna në grup, duke i mësuar atyre aftësi të përgjithshme, specifike dhe "të buta" të tilla, si shkrim-lexim, përdorim i kompjuterit, aftësi për profesionet, aftësi të komunikimit, aftësi të drejtimit etj.



Më poshtë paraqitet një ndër modelet e edukimit për karrierën:

Fusha: Vetëvlerësimi (Hapi 1)

Vetëvlerësimi përbën hapin e parë përmes të cilit sigurohet mbështetja e nxënësve në mënyrë që të njohin dhe të kuptojnë "veten" në pikëpamje të karrierës, në lidhje me interesat, nevojat, mundësitë, të dinë të identifikojnë çfarë është e rëndësishme për ta, pikat e forta dhe të dobëta. Për realizimin e vetëvlerësimit mund të përdoren lista kontrolli, pyetësorë si dhe teknika të tjera të ngjashme.

Fusha: Hulumtimi për karrierën (Hapi 2)

Hulumtimi për karrierën përfshin mbështetjen e nxënësve për të njohur dhe për të kuptuar shtigjet e ndryshme të karrierës, mundësitë që ofrojnë, angazhimin, motivimin, përgjegjësitë etj.

Fusha: Marrja e vendimeve (Hapi 3)

Kjo fushë nënkupton mbështetjen e nxënësve për të qenë të gatshëm për të marrë vendime, për të parashikuar pasojat e vendimeve dhe për të marrë përgjegjësi për zbatimin e tyre.

Fusha: Planifikimi i veprimeve (Hapi 4)

Përfshin mbështetjen e nxënësve për të ndërmarrë zbatimin e vendimeve dhe për të gjetur rrugët e përshtatshme për shmangien e vështirësive që mund të lindin gjatë zbatimit të vendimeve.

Përmes edukimit për karrierën nxënësit zhvillojnë aftësitë/kompetencat për menaxhimin e karrierës. *Aftësitë/kompetencat për menaxhimin e karrierës janë aftësi të cilat duhet t'i mësojë çdo individ për menaxhimin e suksesshëm të karrierës së tij gjatë gjithë jetës.*

FUSHAT	AFTËSITË/KOMPETENCAT
Vetëvlerësimi	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none">▪ Ndërtojnë dhe ruajnë një koncept pozitiv për veten.▪ Ndërveprojnë në mënyrë efektive dhe pozitive me të tjerët.▪ Zhvillojnë strategji për t'iu përgjigjur pozitivisht ndryshimeve në jetë dhe në punë.
Hulumtimi	<ul style="list-style-type: none">▪ Bëhen pjesë e mësimin gjatë gjithë jetës për të mbështetur arritjen e qëllimeve në karrierë.▪ Gjejnë dhe përdorin në mënyrë efektive informacionin e karrierës.▪ Kuptojnë marrëdhëniet ndërmjet punës, shoqërisë dhe ekonomisë.

Fokusimi dhe marrja e vendimeve	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Zhvillojnë aftësitë për të kërkuar, gjetur apo për t'u punësuar. ▪ Marrin vendime për zhvillimin e karrierës.
Planifikimi i veprimeve	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Eksplorojnë dhe kuptojnë ndërveprimin midis roleve në jetë dhe në punë. ▪ Menaxhojnë procesin e zhvillimit të karrierës.

1.3.2.1 Format e organizimit kurrikular të edukimit për karrierën

Nga hulumtimi i përvojave të ndryshme, në lidhje me format e organizimit kurrikular të edukimit për karrierën rezulton se në shumë sisteme arsimore edukimi për karrierën (i njohur gjithashtu si "aftësi të menaxhimit të karrierës") është i përfshirë në kurrikul.

Format më shpeshta të përfshirjes së edukimit për karrierën janë:

A) Edukimi për karrierën përmes qasjes kroskurrikulare

Disa prej sistemeve arsimore e zhvillojnë edukimin për karrierën përmes fushave të të nxënësve, të tilla si p.sh., fusha e gjuhës ku nxënësit mësojnë të shkruajnë një letër aplikimi për punë, të shkruajnë një Curriculum vitae etj; fusha e shkencave shoqërore ku nxënësit mësojnë kuptimin për punën, mënyra të ndryshme organizimit të punës, të drejtat e punës, roli i sindikatave, çështjet gjinore që lidhen me punën etj.

Qasja kroskurrikulare i ndihmon nxënësit të mendojnë përmes çështjeve që lidhen me punën në kontekste të ndryshme dhe përmes temave të lëndëve të ndryshme. Kjo mund të çojë në zhvillimin e mundësive të brendshme të lëndëve, duke krijuar hapësira për t'u zgjeruar, lidhur ngushtësisht me motivimin dhe interesin e nxënësve. Qasja kroskurrikulare kërkon koordinim dhe bashkëpunimin ndërmjet mësuesve si dhe një hartëzim të kurrikulës, në mënyrë që të shmangen mbivendosjet e panevojshme. Ndër disavantazhet e qasjes kroskurrikulare përmendim faktin që kjo lloj qasje nuk ka "pronësi", mund t'i takojë gjithkujt dhe askujt. Kjo është veçanërisht

e rëndësishme në një kurrikul të mbingarkuar, ku ka presion për të përmbushur programin mësimor të lëndës, për shkak të kërkesave për realizimin e tij.

B) Edukimi për karrierën si lëndë e veçantë

Në disa sisteme arsimore, edukimi për karrierën është përfshirë si një lëndë e veçantë brenda kurrikulës, asaj bërthamë ose me zgjedhje.

Kjo formë e organizimit kurrikular ka si avantazh faktin që i siguron një hapësirë të dedikuar edukimit për karrierën, por nga ana tjetër shoqërohet me nevojën e përgatitjes së mësuesve dhe vështirësitë që lidhen me zhvillimin e tyre profesional si pasojë e mungesës së formimit fillestar në universitete.

C) Edukimi për karrierën përmes veprimtarive ekstrakurrikulare

Disa sisteme arsimore zhvillojnë programe të edukimit për karrierën si aktivitete jashtëkurrikulare. Nxënësit ftohen të marrin pjesë në "javën e karrierës" ose në "panairin e karrierës", të vizitojnë vende pune, të marrin pjesë në një program të eksplorimit të punës, të ndjekin prezantime/biseda me prindër, me sipërmarrës etj.

Shumë nga aktivitetet ekstrakurrikulare përgjithësisht organizohen dhe zhvillohen në faza tranzitore të kalimit nga njëri nivel arsimor në tjetrin.

D) Qasje mikse e edukimit për karrierën

Kjo qasje përfshin kombinimin e të gjitha formave të mësipërme të edukimit për karrierën dhe është mënyra më efikase për të zhvilluar edukimin për karrierën.

1.3.3 Këshillimi për karrierën

Këshillimi për karrierën synon t'i ndihmojë nxënësit të aftësohen në planifikimin dhe marrjen e vendimeve të karrierës dhe të jetës së tyre.

Nga praktika e dimë që jo të gjithë nxënësit ndjekin të njëjtën rrugë për të "dalë në jetë". Disa presin çfarë t'u dalë rastësisht, disa priren të shkojnë me rrjedhën dhe përfitojnë nga çfarë u ofrohet, disa mendojnë që nuk kanë shumë zgjedhje, disa as nuk përpiqen të planifikojnë apo të mendojnë për të ardhmen.

Detyra e këshilluesit të karrierës (mësuesi/psikologu i shkollës/punonjësi social) në çdo rast duhet t'i njohë dhe ndërgjegjësojë nxënësit për qasjen e strukturuar që duhet të kenë ndaj zgjedhjeve në jetë, që të mos mbeten pre e rastësisë apo rrethanave të pafavorshme ku mund të ndodhen.

Duke qenë se këshillimi individual mund të jetë shumë konsumues në kohë, këshillohet që të krijohen grupe të vogla nxënësish që ndajnë të njëjtat probleme ose vështirësi. *Këshillimi si proces, duhet të kryhet nga persona të kualifikuar.*

1.4 Parime etike të orientimit për karrierën

Të gjithë personat e përfshirë në ofrimin e shërbimeve për orientimin për karrierën, përfshirë mësuesit, psikologët shkollorë, punonjësit socialë në shkollë, ballafaqohen me dilema etike gjatë punës së tyre të përditshme. Dilemat etike më të zakonshme gjatë praktikimit të orientimit për karrierën në institucionet arsimore parauniversitare janë:

Pavarësia e nxënësit

Praktikuesit e orientimit për karrierën respektojnë lirinë e zgjedhjes së karrierës dhe zhvillimit personal të nxënësit. Praktikuesit e orientimit, përfshirë psikologët shkollorë, nuk duhet t'u imponojnë nxënësve pikëpamjet e tyre për zgjedhjen e karrierës dhe duhet të shmangin "vendimmarrjen" në emër të nxënësit ose prindërve të tij.

Paanësia

Orientimi i dhënë duhet të jetë vetëm në përmbushje të interesave të nxënësit dhe nuk ndikohet nga interesat e ofruesit. Kjo nënkupton që mësuesit/psikologët shkollorë nuk duhet të ndikojnë te nxënësit që të regjistrohen në një shkollë të veçantë ose të marrin një vend pune të caktuar, nëse kjo mundësi nuk është e duhura për nxënësin ose atij nuk i pëlqen. Gjithashtu, nxënësit nuk duhen diskriminuar për shkak të gjinisë, moshës, kombësisë, klasës shoqërore, aftësisë etj.

Konfidencialiteti

Informacionet personale që nxënësit ndajnë gjatë marrjes së shërbimeve të orientimit për karrierën nuk duhen ndarë me të tjerët. Është shumë e rëndësishme mbrojtja e privatësisë së informacioneve personale të nxënësve.

Cilësia

Informacioni që përdoret për orientimin për karrierën duhet të jetë i saktë dhe i përditësuar. Instrumentet e kompjuterizuara dhe teknikat e tjera të përdorura duhet të jenë të përshtatshme për nevojat e nxënësve.

Qasja gjithëpërfshirëse

Është e rëndësishme të merret parasysh konteksti i plotë personal, shoqëror, kulturor dhe ekonomik i nxënësit.



2 ANALIZA E SITUATËS AKTUALE TË ORIENTIMIT PËR KARRIERËN NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

Analiza e situatës aktuale të orientimit të nxënësve për karrierën ka vendosur në fokus të saj tri komponentë:

- ✓ ***Edukimi për karrierën përmes kurrikulës dhe dokumenteve kurrikulare.***
- ✓ ***Legjislacioni për arsimin parauniversitar dhe hapësirat që siguron për orientimin për karrierën.***
- ✓ ***Praktikat dhe përvojat për orientimin e nxënësve për karrierën në institucionet arsimore.***

2.1 EDUKIMI PËR KARRIERËN PËRMES KURRIKULËS DHE DOKUMENTEVE KURRIKULARE

Analiza e situatës së orientimit për karrierën në arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të lartë, pikëniset nga vlerësimi i kësaj situatë në dokumentet themelore të politikës kurrikulare.

- *Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar të Republikës së Shqipërisë.*
- *Kurrikula bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor.*
- *Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të ulët.*
- *Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të lartë.*

Kjo paketë dokumentesh përcakton filozofinë e konceptimit të kurrikulës dhe strategjinë e zhvillimit të saj, e cila projektohet më pas në *programet mësimore të lëndëve sipas klasave 1 - 12-të.*

2.1.1 KORNIZA KURRIKULARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar si dokumenti themelor i politikës kurrikulare integron natyrshëm edukimin për karrierën përmes të gjithë komponentëve të kurrikulës që ajo vendos në fokus dhe synon të zhvillojë. Korniza e thekson dukshëm faktin se “dukuria, gjithnjë e më e shpeshtë, **e ndryshimit të profesioneve** shtron përpara shkollës detyrën e zhvillimit të aftësive, shkathtësive dhe qëndrimeve pozitive për të nxënit gjatë gjithë jetës. ***Qytetarëve të shoqërisë së dijes u nevojitet të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet vetjake, shoqërore dhe ato që lidhen me botën e punës dhe tregun e lirë***”.

Kjo qasje dhe frymë filozofike e kurrikulës përshkon çdo element të Kornizës: parimet e përgjithshme të kurrikulës, synimet e fushave të të nxënit dhe lëndëve që i përbëjnë ato, udhëzimet metodologjike për zbatimin e kurrikulës dhe parimet e vlerësimit të nxënësve.

Dokument i Kornizës kurrikulare si dokument i politikës kurrikulare, e konsideron “orientimin për karrierën” jo thjesht informim, as detyrë të një lënde apo fushe të nxëni; orientimi për karrierën kërkon përpjekje komplekse të të gjitha lëndëve dhe fushave të të nxënit për të krijuar shtratin për ndryshime graduale, për një ndryshim të procesit të të nxënit. Ekzistojnë hapësira dhe mundësi për secilën lëndë që nxënësit përmes detyrave, veprimtarive dhe në mënyrë të veçantë përmes projekteve kurrikulare, të zhvillojnë iniciativën, vetëdrejtimin dhe vetëbesimin, aftësi të punës individuale dhe punës në grup, të zhvillojnë ide dhe të ndërmarrin nisma për t’i zbatuar ato duke marrë parasysh mundësitë dhe risqet për realizimin e tyre.

❖ **Kompetencat kyç për të nxënit gjatë gjithë jetës dhe orientimi për karrierën**

Qasja filozofike e kurrikulës bazuar në kompetenca, e cila përshkon çdo fushë të të nxënit në arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të lartë, konsideron si fokus të formimit të nxënësve,

për pasojë dhe fokus të kurrikulës, zhvillimin e kompetencave kyçe, bazuar në ato europiane, të cilat përcaktojnë çfarë duhet të dinë dhe çfarë duhet të jenë në gjendje të bëjnë si duhet nxënësit, cilat vlera dhe qëndrime duhen kultivuar, si duhen aftësuar ata për bashkëjetesë e tolerancë, si mund të japin ndihmesë në mënyrë aktive për mirëqenien shoqërore dhe vetjake etj.

Shtatë kompetencat kyçe sipas të cilave organizohet kurrikula, të cilat synojnë të aftësojnë nxënësit për të nxënëit gjatë gjithë jetës janë:

- 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit;***
- 2. Kompetenca e të menduarit;***
- 3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë;***
- 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin;***
- 5. Kompetenca personale;***
- 6. Kompetenca qytetare;***
- 7. Kompetenca digjitale.***

Këto kompetenca zhvillojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime që i aftësojnë fëmijët dhe të rinjtë të planifikojnë dhe të menaxhojnë karrierën e tyre:

- ✧ të zhvillojnë personalitetin;***
- ✧ të nxënë dhe të marrin pjesë aktive në shoqëri;***
- ✧ të zhvillojnë aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese, aftësi të nevojshme për vendimmarrje të mirëmenduar;***
- ✧ të zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes dhe të jenë të motivuar për të përmbushur objektivat;***
- ✧ të përdorin kompjuterin për të gjetur, prodhuar, krijuar, prezantuar dhe shkëmbyer informacion si dhe për të bashkëpunuar në rrjetet informuese në internet; etj.***

Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar rezultatet e të nxënëit të kompetencave kyçe që zhvillohen përgjatë arsimit parauniversitar, të përcaktuara në dokumentin e Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar. Me ngjyrë të kuqe janë shënuar rezultatet e të nxënëit

të kompetencave kyçe, të cilat në mënyrë më të drejtpërdrejtë lidhen me edukimin për karrierën dhe zhvillimin e aftësive të menaxhimit të karrierës.

KOMPETENCAT KYÇE	
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit	Kompetenca e të menduarit
<p>✧ <i>Nxënësi komunikon në mënyrë efektive.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Komunikon në gjuhën amtare. ○ Komunikon në gjuhë të huaja. ○ Shprehet me anë të simboleve, kodeve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. ○ Komunikon nëpërmjet teknologjive të informacionit. ○ <i>Përkushtohet dhe kontribuon për dialog konstruktiv.</i> ○ <i>Respekton rregullat e komunikimit.</i> ○ <i>Shpreh tolerancë dhe empati në komunikim.</i> ○ <i>Komunikon në mënyrë konstruktive.</i> 	<p>✧ <i>Nxënësi mendon në mënyrë krijuese.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Analizon, sintetizon, gjykon, vlerëson, interpreton, krijon dhe mbron qëndrimin e tij të pavarur etj. ○ Merr vendime në bazë të informacioneve të plota e të verifikuara. ○ Lidh vendimet me pasojat. ○ Vlerëson dhe vetëvlerësohet. ○ Zgjidh probleme. ○ Zotëron kompetencat në fushat kryesore të dijes (matematikë, shkencë natyrore e shoqërore, teknologji etj.). ○ Zotëron kompetencat digjitale.
Kompetenca e të mësuarit për të nxënë	Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin
<p>✧ <i>Nxënësi mëson për të nxënë.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Identifikon dhe shfrytëzon strategji dhe teknika të të nxënit. ○ Zotëron si duhet leximin, shkrimin, matematikën, shkencën dhe TIK-un. ○ Identifikon dhe përpunon informacione në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. 	<p>✧ <i>Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Paraqet mirë vetveten, duke vënë theksin në pikat e forta. ○ Punon në mënyrë të pavarur dhe në grup. ○ Organizon dhe udhëheq veprimtaritë të nxënit dhe shoqërore. ○ Demonstron shkathtësi sipërmarrëse, njohuri për

<ul style="list-style-type: none"> ○ Mëson dhe shkëmben përvoja pozitive në grup. 	<ul style="list-style-type: none"> planifikimin e punës dhe për shfrytëzimin racional të kohës. ○ Zotëron aftësi për menaxhimin e konflikteve dhe vlerësimin e rreziqeve. ○ Ndërmerr veprime të pavarura dhe të përgjegjshme. ○ Merr pjesë në mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit.
<p>Kompetenca personale</p>	<p>Kompetenca qytetare</p>
<p>✧ <i>Nxënësi bën jetë të shëndetshme.</i></p>	<p>✧ <i>Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.</i></p>
<ul style="list-style-type: none"> ○ Shfaq vetëbesim. ○ Menaxhon emocionet dhe stresin. ○ Ndihmon dhe shfaq empati për të tjerët. ○ Demonstron aftësi për të bërë jetë të shëndetshme. ○ Bën zgjedhje të përgjegjshme për shëndetin vetjak. 	<ul style="list-style-type: none"> ○ Ndërton marrëdhënie me të tjerët, me shoqërinë dhe me kulturat e tjera. ○ Mirëkupton dhe respekton dallimet ndërmjet njerëzve. ○ Pranon dhe respekton të tjerët. ○ Demonstron përgjegjësi për çështje të interesit të përgjithshëm publik. ○ Merr pjesë në mënyrë aktive dhe të përgjegjshme në çështje të interesit publik. ○ Përkrah dhe nxit ndryshime të dobishme për jetën vetjake, për shoqërinë dhe për mjedisin.
<p>Kompetenca digjitale</p>	
<p>✧ <i>Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin</i></p>	
<ul style="list-style-type: none"> ○ Përdor disa aplikacione si: word, spreadsheets, databaza etj. ○ Mbledh dhe përpunon informacionin që gjendet 	

<p>nga interneti apo komunikimi elektronik.</p> <ul style="list-style-type: none">○ Vlerëson rreziqet që vijnë nga interneti apo komunikimi elektronik.○ Gjykon për vërtetësinë e informacionit dhe për parimet etike dhe ligjore në përdorimin interaktiv të TIK-ut.○ Përdor TIK-un për të zhvilluar mendimin kritik dhe krijues.○ Identifikon, analizon dhe përdor sistemet aplikative për zgjidhjen e problemeve.	
---	--

❖ Nivelet e arsimit parauniversitar dhe orientimi për karrierën

Arsimi parauniversitar përfshin:

1. **Arsimin parashkollor** që u ofrohet fëmijëve të moshës 3-6 vjeç pranë institucioneve parashkollore dhe fëmijëve 5-6 vjeç, në klasat përgatitore, pranë shkollave fillore dhe 9-vjeçare;
2. **Arsimin fillor**, që ofrohet nga klasa e parë deri në klasën e pestë;
3. **Arsimin e mesëm të ulët**, që ofrohet nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë;
4. **Arsimin e mesëm të lartë**, që ofrohet në klasën e dhjetë, njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë.

Në Kornizën kurrikulare janë paraqitur karakteristikat e niveleve arsimore ku dukshëm orientimi dhe edukimi për karrierën vendoset në fokus, në mënyrë të veçantë dhe shprehet qartë në **synimet e arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë**, duke i konsideruar si dy faza të rëndësishme të kalimit (transferimit) nga njëri nivel arsimor në tjetrin.

Arsimi i mesëm i ulët:

".....Në këtë nivel, kurrikula pasurohet me përvoja të larmishme të të nxënit (p.sh., kombinimi i qasjeve teorike me praktikën; të menduarit abstrakt dhe veprimet e kontekstualizuara, kontakti me realitetin konkret dhe virtual etj.), që **ata të identifikojnë atë që u pëlqen dhe fushat e interesit**".

Arsimi i mesëm i lartë:

".....Arsimi i mesëm i lartë bazohet në një proces më të gjerë, më të thellë dhe më të specializuar të të nxënit, që merr parasysh **aftësinë e nxënësve për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe orientimin e tyre të ardhshëm drejt studimeve e kualifikimeve të mëtejshme dhe tregut të punës**".

❖ **Shkallët e kurrikulës dhe orientimi për karrierën**

Kurrikula e arsimit parauniversitar është e organizuar në gjashtë shkallë. Në mënyrë të veçantë shkalla e katërt e kurrikulës “Përforcim i arritjeve dhe orientim në karrierë” dhe shkalla e gjashtë “Konsolidim i arritjeve dhe specializim” kanë në fokus orientimin e nxënësve për karrierën, e lidhur kjo me kalimin nga klasa e 9-të në arsimin e mesëm të lartë dhe me kalimin nga arsimi i mesëm i lartë në arsimin universitar ose në tregun e punës. Vlen të theksohet që megjithëse në këto dy shkallë orientimi për karrierën merr një vëmendje të veçantë, ndërhyrja për orientimin për karrierën nis që në shkallën e tretë “Zhvillimi i mëtejshëm i bazave dhe orientim”.

Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit (KSNA)	Nivelet e sistemit të arsimit formal	Shkallët e kurrikulës
KSNA 3	Arsim i mesëm i lartë Klasa XII	Shkalla 6 e kurrikulës Konsolidim i arritjeve dhe specializim
	Arsim i mesëm i lartë Klasat X – XI	Shkalla 5 e kurrikulës Zhvillim themelor i përgjithshëm dhe profesional
KSNA 2	Arsim i mesëm i ulët Klasat VII – IX	Shkalla 4 e kurrikulës Përforcim i arritjeve dhe orientim në karrierë
	Arsim i mesëm i ulët Klasat VI – VII	Shkalla 3 e kurrikulës Zhvillim i mëtejshëm i bazave dhe orientim
KSNA 1	Arsim fillor III – V	Shkalla 2 e kurrikulës Përforcim i bazave dhe zhvillim
	Arsim fillor I – II	Shkalla 1 e kurrikulës
KSNA 0	Klasa përgatitore	Përvetësim i bazave për njohje
	Mosha 3 – 6 vjeç	Shkalla përgatitore e kurrikulës Edukimi në fëmijërinë e hershme

Tabela e mëposhtme paraqet se si përshkallëzohen në mënyrë të dukshme nga shkalla e dytë e kurrikulës³ dhe në vazhdim, aftësitë që lidhen me orientimin për karrierën. Në tabelë është veçuar nga përmbajtja e shkallëve të kurrikulës vetëm ajo pjesë që adreson edukimin dhe orientimin e nxënësve për karrierën.

³ Koncepti i shkallëve të kurrikulës bazohet në veçori të përbashkëta që kanë të bëjnë me karakteristikat e zhvillimit moshor të nxënësve.

Shkalla 2 Kl.3-5	Shkalla 3 Kl.6-7	Shkalla 4 Kl.8-9	Shkalla 5 Kl.10-11	Shkalla 6 Kl.12
<p>Në këtë shkallë, fëmijët përballen me sfida si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ zhvillimi i aftësive për të menduar, për të strukturuar dhe për të orientuar zgjidhjen e problemeve; ✓ kuptimi i përgjegjësisë për vetveten, për të tjerët dhe për mjedisin; ✓ zgjerimi i burimeve të dijes; ✓ kultivimi i pavarësisë në planifikimin dhe realizimin e 	<p>Në këtë shkallë, nxënësit u nënshtrohen sfidave për:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ zhvillimin e mendimit abstrakt dhe kompleks (p.sh., aftësitë e larta intelektuale), që është i nevojshëm për të njohur botën dhe veten, si dhe për zgjidhjen e problemeve; ✓ njohjen e thellë të vetes, të tjerëve dhe të mjedisit natyror dhe shoqëror; ✓ zhvillimin e aftësive për vetëvlerësim; ✓ zhvillimin e aftësive 	<p>Në këtë shkallë, nxënësit ballafaqohen me sfida që kanë të bëjnë me:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ përdorimin e burimeve të informacionit dhe qëndrimin kritik ndaj tij; ✓ zhvillimin e interesit për jetën publike nëpërmjet përfshirjes së drejtpërdrejtë në veprimtari të ndryshme jashtëshkollore; ✓ përballjen me çështje të ndryshme nga jeta reale nëpërmjet 	<p>Në këtë shkallë, nxënësit përballen me sfida që mundësojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ zhvillimin e vetëbesimit; ✓ studimin e thellë dhe të specializuar, duke angazhuar aftësitë për shfrytëzim të burimeve të ndryshme, me një qasje kritike ndaj të dhënave të ndryshme që përdorin; ✓ përkushtim dhe qëndrueshmëri për arritje më të larta, në mësim dhe përgatitje për karrierë si dhe 	<p>Në këtë shkallë, nxënësit u ekspozohen sfidave si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ demonstrimi i aftësive për identifikim të burimeve të domosdoshme dhe për qasjen kritike ndaj të dhënave të ndryshme; ✓ demonstrimi i aftësisë për vendimmarrje të pavarur dhe për marrjen e përgjegjësisë për zgjedhjet dhe veprimet vetjake; ✓ demonstrimi i përkushtimit të tyre për angazhim të vazhdueshëm për të

Raport i analizës së orientimit të nxënësve për karrierën në arsimin parauniversitar

<p>detyrave; ✓ zhvillimi i qëndrimit pozitiv ndaj vetes dhe ndaj të tjerëve; ✓ qëndrimi kritik ndaj zgjidhjes së problemeve.</p>	<p>për komunikim efektiv; ✓ zhvillimin e përgjegjshmërisë për pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore.</p>	<p>projekteve që do të mundësojnë konsolidimin e njohurive të tyre dhe zhvillimin e mëtejshëm të aftësive, vlerave dhe qëndrimeve; ✓ familjarizimin me mundësitë e ndryshme të studimit dhe orientimit në karrierë; ✓ përgatitjen praktike dhe veprimtaritë orientuese që u mundësojnë qartësimin e aspiratave të tyre; ✓ përforcimin e aftësive të vetëvlerësimit; ✓ përforcimin e kompetencave për punë të pavarur, individuale dhe në</p>	<p>për jetë personale, profesionale dhe publike; ✓ përgatitje për të marrë përgjegjësi për jetën e tyre, për të marrë pjesë aktive në jetën shoqërore si qytetarë të përgjegjshëm dhe kompetentë si dhe për të konkurruar me sukses në tregun e punës; ✓ zhvillim si individë dhe si anëtarë të shoqërisë, të aftë dhe me kapacitete të nevojshme për jetë dhe punë që të përballin ndryshimet e ekonomisë vendore dhe globale dhe të mësojnë si të bëjnë zgjidhjen e</p>	<p>nxënë, për studim të mëtejshëm dhe/apo për zhvillim profesional; ✓ demonstrimi i shkathtësive për të zhvilluar dhe për të promovuar strategji për planifikimin e karrierës nëpërmjet kërkimit të shembujve dhe inovacioneve, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e idesë së sipërmarrjes; ✓ demonstrimi i shkathtësive për ndryshimin e konceptit të karrierës, nëpërmjet kërkimit në një spektër më të gjerë të punëve, duke pasur parasysh rëndësinë e zhvillimit të shkathtësive të</p>
--	---	--	---	--

Raport i analizës së orientimit të nxënësve për karrierën në arsimin parauniversitar

		<i>grup.</i>	<i>problemeve në situata të ndryshme në jetën personale dhe profesionale;</i> ✓ <i>përgatitjen për jetë, që të jetojnë të pavarur dhe të përballojnë sfidat dhe të shfrytëzojnë mundësitë që ofron shoqëria bashkëkohore.</i>	<i>transferueshme për mundësitë e karrierës në të ardhmen;</i> ✓ <i>përfshirje në procesin e planifikimit të karrierës vetjake.</i>
--	--	--------------	--	--

2.2 ARSIMI BAZË: Analiza e dokumenteve kurrikulare për arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët

Dokumentet kurrikulare të marra në shqyrtim për të analizuar situatën e edukimit për karrierën në arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët janë:

- Kurrikula bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor.
- Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të ulët.
- Programet mësimore të lëndëve që zhvillohen në arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët.

Nga analiza e dokumenteve të Kurrikulës bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor, dhe arsimin e mesëm të ulët, si dhe nga analiza e programeve mësimore të lëndëve sipas fushave përkatëse të të nxënës⁴ që zhvillohen në këto nivele arsimit, rezultojnë që, në arsimin fillor (klasat 1-5) dhe në arsimin e mesëm të ulët (klasat 6-9) edukimi për karrierën zhvillohet kryesisht përmes qasjes kroskurrikulare.

Në arsimin fillor (klasat 1-5) dhe në arsimin e mesëm të ulët (klasat 6-9) edukimi për karrierën zhvillohet kryesisht përmes qasjes kroskurrikulare.

⁴ Kurrikula e arsimit parauniversitar është strukturuar rreth shtatë fushave të të nxënës. Fushat e të nxënës përbëjnë bazën e organizimit të procesit mësimor-edukativ në shkollë, për çdo nivel arsimor dhe shkallët përkatëse të kurrikulës. Fushat e të nxënës përfshijnë një ose më shumë lëndë. Disa lëndë të fushës mund të jenë pjesë e disa shkallëve kurrikulare. Fushat e të nxënës janë: Gjuhët dhe komunikimi, Matematika, Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi, Artet, Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti, Teknologjia dhe TIK-u.

Kjo nënkupton që në programet mësimore të të gjitha lëndëve janë përfshirë rezultate të nxëni të kompetencave kyçe dhe lëndore që synojnë edukimin e nxënësve për karrierën. ***Në mënyrë të veçantë, rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe synojnë që nxënësit të zhvillojnë aftësitë bazë të menaxhimit të karrierës, si njohjen e dëshirave, mundësive dhe nevojave të tyre, kuptimin e përgjegjësisë për veten dhe për të tjerët, të mësojnë për rëndësinë e çdo profesioni, të orientohen për dëshirat e tyre për të ardhmen, për rëndësinë që ka shkollimi dhe të mësuarit për pajisjen e tyre me njohuritë dhe aftësitë që kërkojnë profesionet që ata dëshirojnë të bëjnë në të ardhmen, sikurse të zhvillojnë aftësi të vetëvlerësimit, të zgjidhjes së problemeve, të mbajtjes së qëndrimit kritik ndaj zgjidhjes së tyre dhe aftësi të vendimmarrjes së mirëmenduar.***

Krahas hapësirës dhe mundësive që krijojnë lëndët mësimore në arsimin bazë, hapësira e kurrikulës në bazë shkolle me 1 orë mësimore/javë në klasat 6-9 si dhe orët e kujdestarisë sigurojnë një hapësirë të lirë kurrikulare ku shkollat mund të zhvillojnë tema të veçanta/veprimtari/module që nxisin zhvillimin e aftësive të menaxhimit të karrierës. Gjithashtu, veprimtaritë esktrakurrikulare përtej orarit mësimor mundësojnë zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për edukimin dhe këshillimin për karrierën me pjesëmarrjen dhe të anëtarëve të tjerë të komunitetit.

Kurrikula në bazë shkolle, me 1 orë mësimore/javë në klasat 6-9 dhe orët e kujdestarisë sigurojnë një hapësirë kurrikulare ku shkollat mund të zhvillojnë tema të veçanta/veprimtari/module që nxisin zhvillimin e aftësive të menaxhimit të karrierës.

Vlen të theksojmë që, në arsimin fillor, edukimi për karrierën nuk synon që nxënësit që në këtë moment të shkollimit të zgjedhin karrierën, por i ndihmon ata të kuptojnë ndërlidhjen e gjithçkaje që bëjnë në jetë. Që në këtë moshë ata fillojnë të hedhin hapat e parë drejt një modeli të vendimmarrjes për karrierën e tyre.

Nga shqyrtimi i kujdesshëm i **kurrikulës bërthamë për arsimin fillor** rezulton që ***në mënyrë të veçantë për "Kompetencën për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin", dhe "Kompetencën personale" janë përcaktuar rezultate të nxëni të cilat adresojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë elementë të aftësive për menaxhimin e karrierës; njohuri, aftësi dhe qëndrime që synojnë zhvillimin e konceptit pozitiv për veten, empatinë, etikën e punës në grup, pavarësinë në kryerjen e detyrave, bashkëpunimin etj.***

Këto rezultate janë të përfshira në programet mësimore të të gjitha lëndëve që zhvillohen në klasat 1-5.

Është e nevojshme të sjellim në vëmendje që vendosja e theksit në këto dy kompetenca nuk përjashton kontributin që japin dhe kompetencat e tjera në zhvillimin e aftësive të menaxhimit të karrierës, përmes rezultateve të tyre të të nxënit.

Në **arsimin e mesëm të ulët (klasat 6-9), kur dukshëm përforcohet mbështetja për orientimin e nxënësve për karrierën,** vihet re që krahas ***Kompetencës për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin, dhe Kompetencës personale, dhe Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit përfshin dukshëm rezultate të nxëni të cilat synojnë që nxënësi të identifikojë burime të ndryshme informacioni për arsimim dhe orientim profesional, të zhvillojë një plan individual për zhvillimin e karrierës së tij etj.***

Këto rezultate janë të përfshira në programet mësimore të të gjitha lëndëve që zhvillohen në klasat 6-9.

Në tabelat e mëposhtme janë prezantuar për secilën shkallë të kurrikulës të arsimit fillor dhe të arsimit të mesëm të ulët, rezultatet e të nxënësve të kompetencave kyçe që zhvillojnë aftësitë e menaxhimit të karrierës.

<p style="text-align: center;">Shkalla 1</p> <p style="text-align: center;">Klasa përgatitore, klasa I, II</p>	<p style="text-align: center;">Shkalla 2</p> <p style="text-align: center;">Klasa III, IV, V</p>
<p>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin</p> <p><i>Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive</i></p>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Përgatit një plan të thjeshtë ditor, me shkrim, vizatim, shenja apo simbole, për dy- tri aktivitete ditore, duke pasur parasysh kohën, vendin, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e detyrës. 2. <i>Kontrollon mjetet /materialet dhe kohën, që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/ aktiviteti (në klasë , shkollë apo jashtë saj).</i> 3. <i>Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve, që organizohen në shkollë me ato në shtëpi dhe i përshkruan në mënyrë individuale përmes njëres nga format e të shprehurit duke i diskutuar në</i> 	<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Përgatit një autobiografi ku prezanton veten, të dhënat personale dhe prirjet, që ka për fusha të caktuara, duke gjetur të përbashkëtat , që ato kanë me profesionet e dëshiruara.</i> 2. <i>Përgatit një plan pune një javor</i> dhe specifikon veprimtaritë prioritare duke argumentuar përzgjedhjen e tyre. 3. <i>Përgatit një projekt të vogël, duke theksuar veprimtaritë kryesore për një çështje , që e shqetëson në shkollë ose komunitet</i> dhe përcakton kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për zbatimin e tij. 4. <i>Identifikon dhe llogarit shpenzimet personale ose familjare</i>

<p>grup.</p> <p>4. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet,..etj) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak , në lagje/komunitet.</p>	<p><i>përgjatë një jave dhe i paraqet ato në formë tabelare/grafike apo në një formë tjetër.</i></p>
<p>Kompetenca personale</p> <p><i>Nxënësi bën jetë të shëndetshme</i></p>	

1. **Merr pjesë në aktivitete fizike (si; rreshtime grupime, ecje, orientim në hapësirë, etj) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e rezultateve të caktuara, luan dhe menaxhon emocionet e veta si në rastet e fitores apo të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet).**
2. **Tregon mënyrën e shfrytëzimit dhe menaxhimit të kohës së lirë në të mirën e shëndetit dhe mirëqenies së vet duke ndarë përvojat me të tjerët.**
3. **Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë , shkollë apo jashtë saj.**
4. **Tregon mënyrat e zgjidhjes të një konflikti, me të cilin është ballafaquar dhe ndan mendimet e ndjenjat e veta me anëtarët e grupit.**

1. Merr pjesë në aktivitete fizike dhe lojëra sportive, **duke u përpjekur për arritjen e rezultateve të përcaktuara, menaxhon emocionet e veta** dhe prezanton para të tjerëve gjendjen fizike dhe shpirtërore, pas realizimit të një aktiviteti fizik apo loje sportive.
2. **Identifikon disa përparësi dhe mangësi të personalitetit të vet dhe jep mendime për përmirësim**, nëpërmjet formave të ndryshme shprehëse.
3. **Propozon alternativa për zgjidhjen konstruktive të një konflikti ndërpersonal** duke analizuar rrethanat, që çuan në konflikt dhe ndan përvojat, mendimet dhe ndjenjat e veta me anëtarët e grupit.
4. **Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët** (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) **drejt arritjes së një qëllimi të përbashkët** (projekti/ aktiviteti në bazë klase /shkolle apo jashtë saj).

Shkalla 3 Klasat VI-VII	Shkalla 4 Klasat VIII-IX
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit <i>Nxënësi komunikon në mënyrë efektive</i>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Shkruan një tekst deri në 500 fjalë (letër, udhëzim, kërkesë, ese etj.), duke respektuar rregullat gjuhësore. 2. Shpreh drejt një mendim apo kërkesë, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare ose të huaj, për një situatë të caktuar (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj), duke ndërvepruar në grup ose në klasë. 3. Përdor programet softuerike për komunikim të drejtpërdrejtë dhe në distancë nëpërmjet formave të caktuara të komunikimit (për nevoja te veta apo si detyrë shkollore). 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Merr pjesë në bashkëbisedime me moshatarët dhe të rriturit për tema me interes mësimor dhe shoqëror duke bërë pyetje, dhënë përgjigje dhe veçuar informacionin kryesor. 2. Prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në grup, duke gërshetuar forma te komunikimit verbal dhe elektronik, si dhe veprimin praktik. 3. Identifikon burime të ndryshme informacioni për arsimim dhe orientim profesional, si dhe zhvillon një plan individual për zhvillimin e karrierës së tij.
Kompetenca e të nxënit	

<i>Nxënësi mëson për të nxënë</i>	
<p>1. <i>Shfrytëzon portofolin personal për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit të përparimit dhe përmirësimit të suksesit në fushën e caktuar.</i></p>	<p>1. <i>Përdor elementët e portofolit personal për vetëvlerësimin dhe identifikimin e anëve të forta, i shfrytëzon ato për përparimin në mësim dhe për orientimin për karrierë.</i></p>
Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin	
<i>Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive</i>	
<p>1. <i>Përgatit planin e punës për organizimin e një aktiviteti të caktuar në shkollë ose në komunitet dhe e realizon atë me sukses.</i></p> <p>2. <i>Zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin.</i></p> <p>3. <i>Përdor programet kompjuterike për përgatitjen e materialeve të nevojshme grafike, ilustrime, disejnine (të ftesave, pamfleteve, njoftimeve apo</i></p>	<p>1. <i>Ndërmerr aktivitete të ndryshme për zgjidhjen e një problemi me rëndësi shoqërore për shkollën ose për komunitet</i> (ekspozitë, fushatë, protestë paqësore, tubim, avokim etj.) në bazë të projektit të hartuar me anëtarë të grupit.</p> <p>2. <i>Përdor programet kompjuterike për përpunimin e të dhënave dhe paraqitjen e vizatimeve/diagrameve të nevojshme</i> për përgatitjen e materialeve individuale apo/dhe publikimeve të ndryshme të shkollës.</p>

publikimeve).

- 4. Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).**

- 3. Zhvillon një plan për shpenzimet dhe kursimet mujore personale, të familjes ose të klasës dhe argumenton rëndësinë e planifikimit të buxhetit.**
- 4. Përdor materiale, burime të ndryshme informimi dhe teknologjinë në shkollë dhe në jetën e përditshme si ndihmë për përparimin në mësim dhe për orientim në karrierë.**

Raport i analizës së orientimit të nxënësve për karrierën në arsimin parauniversitar

Tabela e përfshirjes së rezultateve të të nxënit (RN) të kompetencave kyçe që zhvillojnë edukimin për karrierën dhe aftësitë e menaxhimit të karrierës, sipas fushave të të nxënit, në arsimin bazë.

Fusha e të nxënit	Nuk përfshihen RN	Përfshihen RN	Preken tërthorazi RN
Gjuhët dhe komunikimi		✓	
Matematika		✓	
Shkencat e natyrës		✓	
Shoqëria dhe mjedisi		✓	
Arte		✓	
Edukim fizik, sporte dhe shëndet		✓	
Teknologji dhe TIK		✓	

2.2.1 Analiza e programeve mësimore të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët sipas fushave të të nxënësve

2.2.1.1 FUSHA E TË NXËNËSIT “GJUHËT DHE KOMUNIKIMI”

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët përbëhet nga lëndët Gjuhë shqipe dhe Gjuhë e huaj.

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” i aftëson nxënësit që të përdorin gjuhën për të komunikuar, për të plotësuar interesat e tyre personale dhe për të përmbushur kërkesat e shoqërisë dhe të vendit të punës. Nëse nxënësit nuk janë të aftë të dëgjojnë, flasin, lexojnë dhe shkruajnë mirë, atëherë ata nuk mund të jenë të suksesshëm në shkollë dhe në jetë. Duke pasur një rëndësi të tillë, fusha dhe lëndët që e përbëjnë atë, janë një nga detyrat parësore të arsimit bazë.

Në lëndën e Gjuhës shqipe nxënësit zhvillojnë aftësi të planifikimit të aktiviteteve individuale apo të përbashkëta, të bashkëpunimit, të shprehjes së opinionëve etj, të cilët janë baza të edukimit për karrierën.

Tabela e mëposhtme prezanton rezultate të nxënësve (RN) të kompetencave lëndore që synojnë zhvillimin e aftësive të nxënësve për planifikimin e karrierës dhe zhvillimin e aktiviteteve në funksion të saj.

Lënda Gjuhë shqipe Shkalla 1 (klasat 1-2)	Lënda Gjuhë shqipe Shkalla 2 (klasat 3-5)	Lënda Gjuhë shqipe Shkalla 3 (klasat 6-7)	Lënda Gjuhë shqipe Shkalla 4 (klasat 8-9)
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ <i>përgatit një plan të thjeshtë ditor me shkrim, për dy- tri aktivitete ditore, duke pasur parasysh kohën, vendin, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e detyrës;</i> ■ <i>gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve, që organizohen në shkollë me ato në shtëpi dhe i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit duke i diskutuar në grup;</i> ■ <i>identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në</i> 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ <i>përgatit një autobiografi ku prezanton veten, të dhënat personale dhe prirjet, që ka për fusha të caktuara, duke gjetur të përbashkëtat ,që ato kanë me profesionet e dëshiruara;</i> ■ <i>përgatit një plan pune një javor.</i> 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ <i>përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën;</i> ■ <i>shfrytëzon portofolin personal për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit të përparimit dhe përmirësimit të suksesit në fushën e caktuar;</i> ■ <i>përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme të dijës;</i> ■ <i>parashtron pyetje (pse, çfarë, si,</i> 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ <i>shkruan reportazhe ose kronika për tema të ndryshme;</i> ■ <i>shkruan intervista për figura të njohura të sportit, të kinematografisë, të shkencës, të artit, të letërsisë etj.;</i> ■ <i>shkruan plane veprimtarish për ngjarje, festa e përvjetorë të ndryshëm (p.sh.: me rastin e një përvjetori të hapjes së shkollës së tij, me rastin e një festë lokale etj.);</i> ■ <i>shkruan raporte të shkurtra pas një kërkimi;</i> ■ <i>shkruan një broshurë ose një fletëpalosje për tema dhe lexues të ndryshëm (zgjedhje e nxënësve);</i> ■ <i>shkruan një CV, duke ndjekur strukturën e shkrimit të një teksti të tillë;</i>

shkollë, në shtëpi.		<p><i>kur) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/ problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur;</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ■ <i>menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve</i> gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo diku tjetër); ■ <i>përgatit planin e punës për organizimin e një aktiviteti të caktuar</i> në shkollë ose në komunitet dhe e realizon atë me sukses. 	<ul style="list-style-type: none"> ■ <i>shkruan një njoftim ose një ftesë formale,</i> p.sh., një ftesë për ceremoninë e mbarimit të shkollës 9-vjeçare; ■ <i>shkruan artikuj të ndryshëm</i> për gazeta ose revista.
---------------------	--	---	---

2.2.1.2 FUSHA E TË NXËNIT “MATEMATIKË”

Që në hyrje të programit të shkallës së parë dhe të dytë të Fushës/Lëndës Matematikë, matematika përshkruhet si një fushë studimi e cila integrohet me një sërë fushash të tjera, si arkitektura, inxhinieria etj., në mënyrë që nxënësit të kuptojnë lidhjen e kësaj fushe me jetën e përditshme dhe mënyrën se si integrohen këto fusha të dijes dhe drejtime të profesioneve të ardhshme.

Hyrje e programit mësimor

Një nga aspektet më të rëndësishme është integrimi i matematikës me të gjitha fushat dhe çështjet ndërkurrikulare me qëllim kryesor zotërimin e kompetencave kyçe.

Matematika përdoret në një numër të madh të aktiviteteve të përditshme (p.sh., në media, art, arkitekturë, biologji, inxhinieri, shkenca kompjuterike, financë, vizatime të objekteve të ndryshme etj.). - "Cituar nga Programi mësimor i Matematikës, shkalla e parë".

Vendosja e parimit "çdo nxënës është i aftë të mësojë matematikë", në udhëzimet metodologjike për realizimin e programit të matematikës në shkallën e parë, synon të udhëheqë mësuesin në mënyrë që të mbështesë të gjithë nxënësit, për të rritur besimin në aftësitë dhe potencialet e tyre, pa i paragjykuar ato. Një qasje e tillë pedagogjike i ndihmon nxënësit të kuptojnë që mund të jenë të suksesshëm në çdo fushë, përfshirë fushat që shpeshherë konsiderohen si "të vështira" apo fusha "të mundshme për të qenë të suksesshëm dhe të realizuar" vetëm një grup i caktuar nxënësish. Në këtë mënyrë nxënësit nxiten të mendojnë për rëndësinë e të mësuarit të vazhdueshëm në të gjitha lëndët, për të qenë të aftë të zgjedhin profesionet që dëshirojnë në të ardhmen.

Udhëzime metodologjike për zbatimin e programit mësimor

Përdorimi i metodologjive efikase në procesin e të nxënësve është kusht në rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve, pasi i jep secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes. Mësimdhënia e matematikës e cila udhëhiqet nga parimi që "çdo nxënës është i aftë të mësojë matematikë", synon gjithëpërfshirjen, motivimin, barazinë në të gjitha aspektet dhe bazohet në mësimdhënien dhe nxënien bazuar në kompetenca, mësimdhënien me në qendër nxënësin dhe mësimdhënien e nxënien e integruar. - "Cituar nga programi mësimor i Matematikës për shkallën e parë".

2.2.1.3 FUSHA E TË NXËNIT "SHOQËRIA DHE MJEDISI"

Me fokus të veçantë në arsimin bazë ***Fusha e të nxënësve "Shoqëria dhe mjedisi"*** mundëson që nxënësit të orientohen drejt së ardhmes, të zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes dhe të jenë të motivuar për të përmbushur objektivat.

Në shkallën e parë, fusha përbëhet nga lënda "Edukim për shoqërinë" e cila integron njohuri të qytetarisë me historinë. Në shkallën e dytë, të tretë dhe të katërt, fusha "Shoqëria dhe mjedisi" integron njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera nëpërmjet lëndëve të tilla, si: histori, gjeografi, qytetari. Tematikat e përbashkëta të fushës shërbejnë si instrument i fuqishëm integruar në funksion të zhvillimit të kompetencës për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin si një ndër kompetencat themelore që zhvillon kjo fushë.

Në këtë aspekt, kjo fushë dhe lëndët që e përbëjnë atë synojnë të përgatitin nxënësit:

- të paraqesin veten me shkrim dhe me gojë, duke përpiluar CV-në (biografinë) në formatet e kërkuara;
- të demonstrojnë kompetencat e nevojshme për situatat e ndryshme jetësore dhe drejtimet e ndryshme të karrierës;
- të hulumtojnë dhe shfrytëzojnë mundësi për arsimim, për përgatitje profesionale si dhe për këshillim;
- të demonstrojnë shkathtësi organizative, marrin nisma dhe punojnë në grup;
- të planifikojnë dhe menaxhojnë projekte për të arritur objektiva të caktuara (udhëheqin, delegojnë, analizojnë, komunikojnë, raportojnë, vlerësojnë, monitorojnë, mentorojnë);
- të identifikojnë dhe të vlerësojnë burimet e nevojshme (p.sh., kohën, mjetet financiare, burimet njerëzore);
- të tregojnë fleksibilitet, shpirt krijues, përgjegjshmëri për t'iu përshtatur rrethanave të reja, gjatë realizimit të një detyre;
- të ndërmarrin nisma;
- të demonstrojnë solidaritet dhe të konkurojnë me ndershmëri, gjatë realizimit të detyrave të caktuara.

Në mënyrë të veçantë **lënda e Qytetarisë përmes njohurive, aftësive dhe qëndrimeve që zhvillon, orienton nxënësit të fillojnë të mendojnë për dëshirat e tyre në të ardhmen, pasqyron lidhjen e profesioneve me llojet e punëve që plotësojnë nevojat**

dhe dëshirat e nxënësve etj. Lënda dukshëm dhe qëllimshëm zhvillon aftësi të menaxhimit të karrierës.

Në mënyrë më të detajuar, **në klasën e dytë dhe të tretë në lëndën e Qytetarisë, nxënësit mësojnë për disa ndër llojet e shërbimeve që ofrohen në komunitet, eksplorojnë rreth institucioneve që i ofrojnë këto shërbime, vlerësojnë rëndësinë e bashkëpunimit të komunitetit për përmirësimin e këtyre shërbimeve.**

Në këtë kuptim "studimi i rasteve" nga komuniteti shërben si urë lidhëse ndërmjet formimit të nxënësve në shkollë dhe jetës reale.

Në klasën e tretë, në tematikën "Prodhimi, shpërndarja dhe konsumi" nxënësit njihen e kuptojnë çështjet themelore, që lidhen me vendimet në fushën e veprimtarisë ekonomike, duke lidhur në këtë mënyrë profesionet me veprimtarinë ekonomike. Nxënësit njihen me disa prej profesioneve dhe zhvillojnë aftësi të sipërmarrjes përmes ngritjes së një biznesi (restorant).

Në klasën e katërt, nxënësi shqyrton aftësitë dhe shprehitë e nevojshme për punët që kërkohet nga bizneset ose veprimtaritë ekonomike në një sistem të sipërmarrjes së lirë, **në mënyrë të veçantë aftësitë që lidhen me kërkesat e larta në profesione të caktuara.**

Në klasën e shtatë, nxënësit zgjedhin për të kuptuar më mirë konceptin e njohjes së vetvetes - vetëdijen për aftësitë e tyre, interesat dhe vlerat – gjatë shqyrtimit të arsimit, karrierës dhe zgjedhjeve të tjera për jetën. Ata mësojnë të vendosin qëllime për të ardhmen e tyre financiare. Nxënësit zgjedhin Kartat e punësimit dhe vëzhgojnë, se si punë të ndryshme sigurojnë të ardhura të ndryshme mujore.

Në klasën e tetë në lëndën e Qytetarisë, nxënësit eksplorojnë grupimet e profesioneve që lidhen ndërmjet tyre nga aftësitë dhe produktet.

Ata identifikojnë punët ose profesionet që do të jenë objekt i eksplorimit të mëtejshëm. Në të njëjtën kohë ata njohin dhe pranojnë vlerën dhe nevojën për të gjitha profesionet.

Nxënësit mësojnë katër faktorët kryesorë që duhet të analizohen dhe të merren parasysh në zgjedhjen e një profesioni ose pune. Ata eksplorojnë më nga afër disa nga fushat e industrisë/të ekonomisë, të cilat parashikohen të kenë më shumë mundësi punësimi dhe, për rrjedhojë, janë parësore për t'u njohur dhe eksploruar më thellë nga nxënësit.

Nxënësit njihen me aspektet kryesore të procesit të kërkimit të punës përmes pjesëmarrjes në një lojë, në të cilën lojtarëve u kërkohet të zgjedhin nga një grup çështjesh, pyetjesh, informacionesh etj. Nxënësit mësojnë të bëjnë dallimin ndërmjet aftësive teknike dhe aftësive të përgjithshme vetjake që lidhen në një mënyrë ose tjetër, pothuajse me të gjitha punët. Ata dallojnë dhe pranojnë ndikimin që ka sjellja e tyre vetjake në arritjen ose mosarritjen e suksesit në punë.

Edukimi për karrierën përmes lëndëve “Edukim për shoqërinë” dhe “Qytetari”

Klasa 2	Klasa 3	Klasa 4	Klasa 7	Klasa 8
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✧ <i>Dallon lloje të ndryshme punësh në komunitet përshkruan si jetojnë dhe si punojnë njerëzit në një komunitet.</i> ✧ <i>diskuton për mundësitë e ndryshme të punëve që ekzistojnë në një komunitet.</i> 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✧ <i>Dallon disa nga shërbimet për të cilat njerëzit kanë nevojë në lagjen ku banojnë (pastrimi, mbrojtja nga zjarri, parqet pushimi, kënde lojërash etj);</i> ✧ <i>dallon disa nga institucionet që mund të ofrojnë shërbime për komunitetin ku jeton (për shembull, tregon se çfarë shërbime mund ofrojnë policia, zjarrfikësit etj.);</i> ✧ <i>përshkruan disa nga veprimet që janë të domosdoshme për të shfrytëzuar shërbimet e komunitetit ku jeton në rast nevoje;</i> ✧ <i>tregon se çfarë mund</i> 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✧ <i>Identifikon aftësitë që mbështesin kërkesat, gjithnjë në rritje, të vendeve të punës;</i> ✧ <i>analizon aftësitë e tij dhe sheh si ato përshtaten në një vend pune të caktuar.</i> ✧ <i>identifikon punë ose profesione që janë të lidhura me njëra-tjetrën dhe grupimet e aftësive që nevojiten për to;</i> ✧ <i>krijon një përmbledhje të thjeshtë;</i> ✧ <i>përshkruan specializimet dhe konkurrencën në biznes;</i> ✧ <i>tregon nevojat globale të shumë bizneseve.</i> 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✧ <i>Përdor reflektimet e tij vetjake për të shpjeguar njohjen e vetvetes;</i> ✧ <i>zbaton aftësitë e tij, interesat dhe vlerat për të përcaktuar rrugët e tij të mundshme të karrierës.</i> ✧ <i>identifikon lidhjet ndërmjet vendosjes së qëllimeve, financave vetjake, arsimit dhe karrierës;</i> ✧ <i>zbaton vendimmarrjen në zgjedhjet për arsimin dhe karrierën.</i> 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✧ <i>Shqyrton grupimet e profesioneve dhe eksploron më tej profesionin/profesionet brenda çdo grupimi që janë në interes të tij;</i> ✧ <i>përshkruan ndërvarësinë dhe vlerën e të gjitha llojeve të punëve (profesioneve);</i> ✧ <i>përshkruan katër faktorët themelorë që duhet të merren parasysh në zgjedhjen e një pune (profesioni);</i> ✧ <i>përshkruan industrinë që parashikohen të rriten me ritme të larta;</i> ✧ <i>identifikon aftësitë për punë të zhvilluara nga përvojat dhe veprimtaritë e</i>

	<p>dhe duhet të bëjnë fëmijët dhe banorët e tjerë të komunitetit për të rritur cilësinë e shërbimeve dhe të përfitimit prej tyre;</p> <ul style="list-style-type: none"> ✧ flet për punën e projektuesit të një qyteti; ✧ përshkruan aftësitë që i duhen një ndërtuesi; ✧ tregon se si puna e një ndërtuesi lidhet me atë të projektuesit të qytetit; ✧ merr një vendim në grup, të nevojshëm për të ndërtuar një restorant; ✧ vendos për llojin e restorantit; ✧ diskuton dhe të përzgjedh vendin më të mirë për të ngritur restorantin. 			<p>mëparshme;</p> <ul style="list-style-type: none"> ✧ planifikon objektiva të rëndësishëm që duhet t'i arrijë për të qenë në gjendje të fitojë një punë të caktuar; ✧ përshkruan mjetet kryesore të kërkimit të një pune, duke përfshirë këtu edhe aplikimet për punë, CV, rekomandimet dhe intervistat.
--	--	--	--	--

Si pjesë e fushës "Shoqëria dhe mjedisi", lënda e Gjeografisë e cila zhvillohet në klasat 6-9 stimulon të nxënin bazuar në kërkim, duke zhvilluar aftësinë e nxënësve për të menaxhuar veten. Nxënësit kuptojnë rolin e tyre në procesin e të nxënimit dhe në kryerjen e hetimeve, aftësohen të jenë të pavarur në zbatimin e njohurive dhe shkathtësive, dhe në marrjen e vendimeve. Përmes punës në bashkëpunim në klasë dhe në terren, nxënësit zhvillojnë aftësitë ndërpersonale dhe mësojnë të vlerësojnë perspektivat e ndryshme të anëtarëve të tjerë të grupit. Në ***klasën e 6-të lënda e gjeografisë i njeh nxënësit me profesionin e gjeografit. Nxënësit aftësohen të diskutojnë mbi rolin e gjeografit në studimin e dukurive fizike dhe humane gjeografike, duke evidentuar kontributet që i sjell shoqërisë.***

2.2.1.4 FUSHA E TË NXËNIT "SHKENCAT E NATYRËS"

Fusha e shkencave të natyrës në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët integron njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera nëpërmjet lëndëve: Kimi, Fizikë, Biologji. Mësimi i shkencave natyrore iu ofron nxënësve mundësi për të zhvilluar të kuptuarit e koncepteve dhe të proceseve shkencore, të praktikave më të përdorura për zhvillimin e njohurive shkencore, të kontributit të shkencës në shoqëri dhe të zbatimeve të saj në jetën e përditshme.

Në programet mësimore të kësaj fushe të nxëni, qëllimet e fushës së shkencave të natyrës janë përcaktuar në funksion të të nxënimit gjatë gjithë jetës, që do të thotë se kjo fushë të nxëni synon të përgatisë nxënësin në mënyrë të tillë që të mund të vetëzhvillohet dhe të vetëfunksionojë, aftësi këto vetëmenaxhuese mjaft të rëndësishme në pikëpamje të edukimit për karrierën.

Programet mësimore të lëndëve Biologji, Fizikë dhe Kimi përpiqen të ngjallin interesin për shkencën e jetës. Me fokus formimin e aftësive të nxënësve për jetën programet zhvillojnë dhe nxitin zgjidhjen në mënyrë krijuese të problemeve, të eksperimentuarit, të punuarit në grup, përdorimin efektiv të teknologjisë.

Përmes detyrave hulumtuese dhe krijuese, punëve në grup dhe atyre individuale, projekteve dhe detyrave kërkimore nxënësit nxiten të diskutojnë, të hulumtojnë, si dhe të gjejnë rrugëzgjdhje për probleme të ndryshme, si ndotja, mbipopullimi, përdorimi i energjisë etj.

Udhëzimet metodologjike për zbatimin e programeve sugjerojnë përdorimin e metodave ndërvepruese të cilat i nxitin nxënësit të jenë aktivë, të hetojnë në lidhje me dukuritë fizike, të debatojnë dhe zhvillojnë punën në grup. ***Një ndër elementët e rëndësishëm që programet synojnë të zhvillojnë janë dhe qëndrimet intelektuale të nxënësve, si ndjenja e iniciativës, interesi për prezantimin e ideve të ndryshme, ndjenja e përgjegjësisë për zgjidhje origjinale, ndjenja e bashkëpunimit gjatë punës në grup.***

2.2.1.5 FUSHA E TË NXËNIT “ARTE”

Fusha e arteve në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët integron njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera nëpërmjet lëndëve: Art pamor, Muzikë, Teatër, Kërcim. Aspektet e të nxënësve në fushën e arteve, zhvillojnë mundësitë e nxënësve për të njohur gjuhën artistike të arteve, për të realizuar dhe për të prezantuar punë të ndryshme artistike, për të vlerësuar veprat e arteve të ndryshme. Në pikëpamje të edukimit për karrierën artet stimulojnë ndërgjegjësimin trupor, ushqejnë imagjinatën dhe kontribuojnë në zhvillimin e vetëbesimit. Fusha e arteve ndihmon në krijimin e identitetit dhe në pasurimin e botëkuptimit të nxënësve, mundëson zhvillimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar, nëpërmjet trajtimit të elementeve dhe vlerave artistike kulturore të trashëgimisë sonë kombëtare. Kurrikula e arteve nxit nxënësit të jenë aktivë dhe të marrin përsipër përgjegjësi për të mësuarit e tyre, të përdorin strategji dhe teknika mësimore që nxitin ndërveprimin, pjesëmarrjen mësimore dhe mbështetin gjykimin kritik dhe estetik mbi veprat e ndryshme.

Në fushën e arteve, duke filluar që në klasën përgatitore e në vazhdim nxënësve u jepet mundësia që përmes njohurive që përcjellin lëndët të zbulojnë disa profesione

që lidhen me artin, si artist, artizan, piktor, skulptor, këngëtar, regjisor etj, dhe të fillojnë të eksplorojnë lidhur më aftësitë që nevojiten për të zhvilluar këto profesione.

2.2.1.6 FUSHA E TË NXËNIT “EDUKIM FIZIK, SPORTE DHE SHËNDETI”

Fusha e të nxënësve “Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti” u afron nxënësve një platformë nga e cila mund të ndërtojnë kompetenca për të përmirësuar kapacitetet fizike, si dhe i ndihmon ata në zhvillimin e aftësive personale dhe ndërpersonale.

Të përshtatësh një stil jetese aktiv dhe të shëndetshëm do të thotë të krijosh mundësitë për të jetuar një jetë, e cila karakterizohet nga një mirëqenie e përgjithshme fizike, mendore dhe emocionale, në të cilën një individ gëzon aftësi për të ekzekutuar çdo ditë detyra energjikisht dhe aktivisht, kryen me kënaqësi aktivitetet e kohës së lirë dhe realizon lehtësisht kërkesat e ditës.

Njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që zhvillon kjo fushë janë parakushte të domosdoshme për një individ që synon të ndërtojë një karrierë të suksesshme, pasi krijimi i një modeli jetese të shëndetshëm sjell efekte të pëlqyeshme afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur disa ndër rezultatet e të nxënësve të fushës “Edukim fizik, sporte dhe shëndet” që nxisin edukimin për karrierën.

Nxënësi:

- ✧ Zhvillon plane të thjeshta individuale të të ushtruarit me aktivitet fizik e sportiv, jashtë programit mësimor.
- ✧ Argumenton vlerat e aktivitetit fizik në rritjen e mirëqenies fizike, emocionale e mendore të tij/saj.
- ✧ Menaxhon emocionet e tij/saj dhe i përshtat ato në situata të ndryshme (psh. punë në grupe, lojë në shkollë dhe jashtë saj etj).
- ✧ Aktivizohet në veprimtari fizike e sportive që shkolla organizon brenda dhe jashtë

programit mësimor.

- ✧ Argumenton pse çdo individ është unik e i ndryshëm, si dhe mundësitë që shkolla dhe mjedisi ku jeton duhet të ofrojnë që të gjithë të jenë të barabartë dhe të mirëpritur.
- ✧ Zhvillon plane të thjeshta individuale për ushqim të shëndetshëm sipas sezoneve, periudhave ditore dhe zbaton rregulla për një ushqim të shëndetshëm.

2.2.1.7 FUSHA E TË NXËNIT “TEKNOLOGJI DHE TIK”

Në arsimin bazë, fusha e të nxënit “Teknologji dhe TIK” përfshin lëndët: Aftësim teknologjik praktik dhe TIK.

Lënda Aftësim teknologjik praktik ka për qëllim të zhvillojë te nxënësi aftësitë për të njohur, eksploruar dhe analizuar sisteme të thjeshta teknologjike, kjo, për të lehtësuar përshtatjen e tyre me mjedisin teknologjik që i rrethon. Për më tepër, kjo lëndë i ndihmon nxënësit për të planifikuar, projektuar dhe zhvilluar praktikisht mjete, metoda apo procese të thjeshta teknologjike, si dhe për të bërë vlerësimin e produktit përfundimtar. Aftësitë e përfshira do të zhvillohen në mënyrë progresive, ku nxënësit orientohen në zbatimin e fazave të përcaktuara për zgjidhjen e problemeve të thjeshta teknologjike. ***Përfshirja në hulumtimin, planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e veprimtarive apo të produkteve të marra nga situata të përditshme, rrisin të kuptuarit dhe zgjojnë interesin e nxënësve për këtë fushë të veprimtarisë njerëzore.***

Në mënyrë të veçantë lënda e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) zhvillon te nxënësit aftësi të rëndësishme për jetën dhe për zhvillimin e karrierës së tyre. Sot TIK -u përshkon të gjitha aspektet e jetës, duke siguruar mënyra të reja, më të mira dhe më të shpejta për njerëzit që të ndërveprojnë, të rrjetëzojnë, të kërkojnë ndihmë, të kenë akses në informacion dhe të mësojnë. Në kohët e sotme, Teknologjia dhe TIK-u janë kthyer në një mënyrë jetese, me të cilën fëmijët dhe të rinjtë ndeshen që në vitet e para të jetës. Në një botë, ku ndeshesh me shumë lloje teknologjish, të cilat janë pjesë e

jetës së përditshme për të gjithë njerëzit, kjo fushë ndihmon që nxënësit të pajisen me aftësi për t'u përballur me to, me vetëbesim, aftësohen të bëjnë gjykime vetjake mbi çështjet që lidhen me ndikimin e teknologjisë në jetët e tyre, në shoqëri dhe në mjedis.

Kjo lëndë synon të kontribuojë në një edukim të balancuar, duke iu dhënë nxënësve një përvojë të gjerë dhe sfiduese, që u krijon mundësi atyre të fitojnë një grup njohurish, kuptimesh, aftësish njohëse e përpunuese dhe kompetenca të thjeshta, duke i përgatitur në këtë mënyrë që të jenë pjesëmarrës në një botë teknologjike.

Nxënësit mësojnë të përdorin TIK për të kërkuar informacion, për të kryer detyra që u ngarkohen, për të prezantuar punime dhe produkte të punës së tyre etj.

2.3 ARSIMI I MESËM I LARTË: ANALIZA E DOKUMENTEVE KURRIKULARE PËR ARSIMIN E MESËM TË LARTË

Arsimi i mesëm i lartë (klasat 10-12) bazohet në një proces më të gjerë, më të thellë dhe më të specializuar të të nxënësve, që merr parasysh aftësinë e nxënësve për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe orientimin e tyre drejt studimeve e kualifikimeve të mëtejshme dhe drejt tregut të punës.

Në këtë nivel, si në shkollat e arsimit të mesëm të përgjithshëm (gjimnazet), ashtu edhe në shkollat profesionale, procesi i përvetësimit të dijeve dhe zhvillimit të njohurive, shkathtësive, qëndrimeve e vlerave bazohet në nevojën e të rinjve për të marrë përgjegjësi për jetën e tyre, për të marrë pjesë si qytetarë aktivë dhe kompetentë në zhvillimet shoqërore dhe për t'u integruar me sukses në tregun e punës.

Dokumentet kurrikulare të marra në shqyrtim për të analizuar situatën e edukimit për karrierën në arsimin e mesëm të lartë janë:

- *Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të lartë.*
- *Programet mësimore të lëndëve që zhvillohen në arsimin e mesëm të lartë.*

Nga analiza e dokumenteve të Kurrikulës bërthamë për arsimin e mesëm të lartë, si dhe nga analiza e programeve mësimore të lëndëve sipas fushave përkatëse të të nxënësve që zhvillohen në këtë nivel arsimi rezulton që në arsimin e mesëm të lartë (klasat 10-12) edukimi për karrierën zhvillohet si qasje e kombinuar: përmes formës kroskurrikulare, e integruar përmes lëndëve të ndryshme dhe si modul i veçantë kurrikular në kurrikulën me zgjedhje, i titulluar "Edukim për karrierën".

Në arsimin e mesëm të lartë (klasat 10-12), edukimi për karrierën zhvillohet si qasje e kombinuar:

- përmes formës kroskurrikulare, dhe*
- si modul i veçantë kurrikular në kurrikulën me zgjedhje, i titulluar "Edukim për karrierën."*

Kurrikula në bazë shkolle, krahas orëve të kujdestarisë dhe veprimtarive përtej orarit mësimor, është një hapësirë e lirë ku shkollat mund të zhvillojnë tema/veprimtari/module për orientimin e nxënësve për karrierën.

Kurrikula në bazë shkolle, krahas orëve të kujdestarisë dhe veprimtarive përtej orarit mësimor, është një hapësirë e lirë me 0-2 orë/javë në klasat 10-12, ku shkollat mund të zhvillojnë tema/veprimtari/module për orientimin e nxënësve për karrierën.

Përsa i takon formës kroskurrikulare të zhvillimit të edukimit për karrierën, nga shqyrtimi i kujdesshëm i ***kurrikulës bërthamë për arsimin e mesëm të lartë*** rezulton që ***në mënyrë të veçantë për "Kompetencën e komunikimit dhe të shprehurit", "Kompetencën për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin", dhe "Kompetencën personale" janë përcaktuar rezultate të të nxënësve të cilat adresojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë elementë të aftësive për menaxhimin e karrierës, rezultate që synojnë zhvillimin e konceptit pozitiv për veten, empatinë, etikën e punës në grup, pavarësinë në kryerjen e detyrave, bashkëpunimin etj.***

Në tabelën e mëposhtme janë prezantuar për secilën shkallë të kurrikulës të arsimit të mesëm të lartë, rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që në mënyrë të drejtpërdrejtë zhvillojnë edukimin për karrierën dhe aftësitë e menaxhimit të saj. ***Këto rezultate të nxëni janë të përfshira në programet mësimore të të gjitha lëndëve të arsimit të mesëm të lartë, si për lëndët e kurrikulës bërthamë, ashtu dhe për lëndët e kurrikulës me zgjedhje.***

Nr	Shkalla 5 Klasa X-XI	Shkalla 6 Klasa XII
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Nxënësi komunikon në mënyrë efektive		
1.	Përdor drejt strukturën dhe rregullat standarde të drejtshkrimit të gjuhës amtare në kontekste dhe forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, e-mail (postë elektronike), letër formale dhe joformale etj	Përdor drejt strukturën dhe rregullat standarde të drejtshkrimit të gjuhës amtare dhe gjuhës së huaj në një numër të caktuar të konteksteve, si: ese, e-mail, letër formale dhe joformale etj.
2.	Prezanton një projekt artistik, humanitar, eksperimentues etj.) nga fusha të ndryshme mësimore, të hartuar individualisht dhe në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera.	Angazhohet dhe kontribuon në një diskutim me të tjerët për një temë të caktuar, p.sh. për edukimin medial, duke paraqitur argumente të bazuara në fakte për rolin dhe ndikimin e televizionit, radios, shtypit dhe mjeteve të tjera të informimit në shoqëri, në procesin e përgatitjes së të rinjve për jetë të pavarur dhe orientim në karrierë.
3.	Përdor TIK-un në mënyrë efektive gjatë komunikimit dhe ndërveprimit me të tjerët në jetën e përditshme, duke përfshirë edhe të nxënit e informacioneve të reja dhe kryerjen e detyrave shkollore.	Përdor në mënyrë efektive, programet e TIK-ut gjatë procesit të të nxënit (duke përfshirë edhe të nxënit në distancë) dhe kryerjes së detyrave në një fushë të caktuar mësimore.

Kompetenca e të menduarit Nxënësi mendon në mënyrë krijuese		
1.	<p>Prezanton, në forma të ndryshme të të shprehurit, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informatave për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh., temë nga shkenca, nga kultura, nga arti, nga sporti, nga shëndetësia, nga shoqëria, nga mjedisi etj).</p>	<p>Sqaron ecurinë e zgjidhjes së një problemi në klasë apo jashtë saj, duke e vërtetuar zgjidhjen e problemit përmes metodës së analizës dhe e prezanton para moshatarëve apo para të tjerëve.</p>
2.	<p>Llogarit me saktësi koston e buxhetit të planifikuar për një aktivitet të caktuar (p.sh., ekskursion, përvjetor i shkollës, një konkurs, një program arsimor për TV etj.), e prezanton atë me gojë dhe me shkrim para klasës, duke përdorur arsyetimin matematikor.</p>	<p>Identifikon burimet e informacioneve të nevojshme dhe i shfrytëzon ato në mënyrë të duhur për të zgjidhur një problem në nivelin e caktuar të vështirësisë, duke dhënë shembuj konkretë.</p>
3.	<p>Dizajnon, me një grup të nxënësve/ moshatarëve, një faqe të Internetit për përdorim interaktiv nga ana e nxënësve lidhur me tema nga fusha të ndryshme mësimore, e mirëmban atë sipas rregullit dhe paraqet një model të nxitjes së moshatarëve që t'i përdorin informacionet në mënyrë të përgjegjshme.</p>	<p>Zbaton njohuritë dhe përvojën në kontekst të zgjidhjes së një problemi nëpërmjet veprimeve të përshtatshme, p.sh. përfshin të rinjtë në një debat për tema me interes shkencor, shoqëror, historik, kombëtar etj., vetëm pasi të jenë bërë përgatitjet e duhura dhe të jetë bërë informimi i të gjithëve.</p>
4.	<p>Simulon një situatë për marrjen e një vendimi për jetën e vet ose zgjidhjen e një problemi me interes shoqëror, lidh vendimin me pasojat në mënyrë të përgjegjshme, e prezanton gjatë</p>	

	<p>një debati me moshatarë në një kohëzgjatje të caktuar, duke u bazuar në këtë përvojë, merr vendime dhe iniciativa të dobishme për vete, për shkollën dhe më gjerë.</p>	
<p>Kompetenca e të nxënit Nxënësi mëson për të nxënë</p>		
1.	<p>Përgatit me sukses një përmbledhje të dosjes personale (portofolit), me jo më pak se 900 fjalë, me qëllim të vetëvlerësimit të përparimit të vet në një fushë mësimore të caktuar, veçon në fund të përmbledhjes disa çështje që vërtetojnë përparimin e vet dhe disa nevoja të domosdoshme për përmirësimin e avancimit të mëtejshëm.</p>	<p>Paraqet një plan studimi (në formë skice, vizatimi, shkrimi etj.) për ndonjë çështje të caktuar (p.sh., vlerat kulturore të rajonit të vet, vlerat e edukimit në shoqëri etj.) duke respektuar të gjithë hapat e planit të studimit dhe e paraqet para të tjerëve.</p>
2.	<p>Shfrytëzon, në mënyrë të pavarur dhe efektive, teknologjinë informative dhe burime të tjera të informimit për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes.</p>	<p>Shkruan një letër motivuese në të cilën arsyeton angazhimin e vet për pjesëmarrje në një prezantim, promovim ose konkurs nga një fushë e caktuar mësimore, duke vënë theksin në aftësitë dhe cilësitë personale në raport me angazhimin e synuar.</p>
3.	<p>Kërkon dhe shfrytëzon në mënyrë të duhur këshilla dhe informacione për kapërcimin e vështirësive në të nxënë në një fushë të caktuar dhe më pas prezanton rezultatet e arritura.</p>	<p>Përzgjedh punimet kryesore të dosjes së vet për të shpjeguar para një audience të caktuar strategjitë që ka zbatuar për të ndjekur avancimin e vet dhe masat e aplikuara për të përmirësuar përparimin në mënyrë të vazhdueshme.</p>

<p>4.</p>	<p>Paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi, shkrimi, vepre artistike etj.).</p>	<p>Vlerëson, në mënyrë kritike, punën e vet duke iu referuar qëllimeve fillestare të punës, p.sh. në mënyrë të pavarur redakton një dorëshkrim të tij me qëllim të përmirësimit të organizimit të shkrimit, qartësisë së mendimit etj.</p>
<p>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive</p>		
<p>1.</p>	<p>Përditëson biografinë personale (CV) sipas formatit dhe udhëzimeve të kërkuara si dhe prezanton veten me shkrim ose me gojë para të tjerëve, duke vënë theksin në aftësitë, dëshirat, mundësitë referuar qëllimeve apo projektit individual për karrierën.</p>	<p>Përcakton prioritete, jep zgjidhje cilësore për përmirësimin e mjedisit si dhe zbaton parimet e tregut të lirë dhe buxhetimit në situata të jetës reale</p>
<p>2.</p>	<p>Hulumton dhe analizon forma të ndryshme të sipërmarrjes për mundësi të orientimit për karrierën, si dhe për të kontribuar në të mirë të komunitetit.</p>	<p>Argumenton me shembuj konkretë lidhjet midis punës, profesionit dhe karrierës, prezanton vendimarrjen personale referuar mundësive në dispozicion për arsimim/ trajnim të mëtijshëm, mundësive personale dhe financiare si dhe argumenton zgjidhjet për realizimin e planit personal të karrierës.</p>
<p>3.</p>	<p>Demonstron iniciativë në zhvillimin dhe zbatimin e ideve sipërmarrëse, përmes organizimit të veprimtarive në shkollë ose në komunitet (p.sh., organizimin e një panairi, konference etj.) si dhe harton raportin duke vlerësuar rezultatet e arritura me rezultatet e parashikuara, pjesëmarrjen dhe mënyrën e prezantimit.</p>	<p>Paraqet modelin e një drejtuesi të një ndërmarrjeje ose organizate, nëpërmjet njërës prej formave të shprehjes, sipas imagjinatës personale, duke respektuar karakteristikat kryesore të një sipërmarrësi të suksesshëm.</p>

4.	<p>Harton një plan (individualisht ose në grup) për zhvillimin e biznesit në rrethin ku jeton (referuar të dhënave lokale dhe prirjeve globale), duke u mbështetur në analizën e shanseve/mundësive, rreziqeve, e prezanton para të tjerëve, duke dhënë argumente të ndikimit të planit të zbatuar në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe mirëqenien e qytetarëve.</p>	<p>Përdor aftësitë digjitale për llogaritjen, analizën, interpretimin dhe paraqitjen e të dhënave me informacione të nevojshme (p.sh., të një mjedisi të biznesit), duke renditur të dhënat sipas nevojave dhe prioriteteve të ndërmarrjes ose organizatës.</p>
<p>Kompetenca personale Nxënësi bën jetë të shëndetshme</p>		
1.	<p>Analizon përparësitë dhe dobësitë personale, duke i evidentuar masat përmes, të cilave synon të mbështesë avancimin personal, në përparësitë që ka dhe masat përmes të cilave synon të përmirësojë dobësitë personale.</p>	<p>Demonstron vetëbesim dhe shkathtësi personale e ndërpersonale në jetën e përditshme, duke dalluar me kohë aspektet pozitive për veten dhe duke ndërmarrë veprime konkrete për arritjen e rezultateve të synuara personale.</p>
2.		<p>Prezanton në forma të ndryshme shprehëse, mënyrën e zbatimit të planeve personale të jetës (p.sh., në shkollim, në karrierë, në sport, në shoqëri, në biznes etj.), vlerëson nivelin e arritjeve të qëllimeve të synuara dhe ilustron shembuj të veçantë të planeve personale për të ardhmen.</p>
3.		<p>Shpreh në forma të ndryshme, qëndrimin e vet të pavarur për përgjegjësinë e të qenit prind/kujdestar, planifikimin e familjes dhe merr vendime të drejta për të ardhmen e tij.</p>

Raport i analizës së orientimit të nxënësve për karrierën në arsimin parauniversitar

Tabela e përfshirjes së rezultateve të të nxënësve (RN) të kompetencave kyçe që zhvillojnë edukimin për karrierën dhe aftësitë e menaxhimit të karrierës, sipas fushave të të nxënësve,

Fusha e të nxënësve	Nuk përfshihen RN	Përfshihen RN	Preken tërthorazi RN
Gjuhët dhe komunikimi		✓	
Matematika		✓	
Shkencat e natyrës		✓	
Shoqëria dhe mjedisi		✓	
Arte		✓	
Edukim fizik, sporte dhe shëndet		✓	
Teknologji dhe TIK		✓	

në arsimin e mesëm të lartë.

2.3.1 Analiza e programeve mësimore të arsimit të mesëm të lartë sipas fushave të të nxënësve

2.3.1.1 FUSHA E TË NXËNËSIT “GJUHËT DHE KOMUNIKIMI”

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” në arsimin e mesëm të lartë përbëhet nga lëndët Gjuhë shqipe, Letërsi dhe Gjuhë e huaj.

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” i aftëson nxënësit që ta përdorin gjuhën për të komunikuar, për të plotësuar interesat e tyre personale, për kënaqësi estetike, për të marrë informacion, si dhe për të përmbushur kërkesat e shoqërisë dhe të vendit të punës. Kurrikula e fushës “Gjuhët dhe komunikimi” bazohet në parimin se të gjithë nxënësit kanë mundësi që të arrijnë rezultate të mira dhe të jenë të suksesshëm, duke i motivuar për karrierën e tyre të ardhshme.

Gjatë të tri viteve, nxënësit krijojnë, organizojnë dhe përzgjedhin ide për të shkruar për qëllime, audienca dhe situata të ndryshme. Ata zbatojnë hapat e domosdoshëm të procesit të shkrimit (planifikimi, organizimi i punës me shkrim, rishikimi, redaktimi etj.). Të shkruarit u jep mundësi nxënësve të mësojnë për veten e tyre dhe të lidhen me botën.

Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësit përmirësojnë aftësitë e tyre për të komunikuar dhe për të prezantuar ide në situata formale. Nëpërmjet këtyre situatave, nxënësit aftësohen për të folurit në publik.

Ata mësojnë të flasin qartë, bindshëm e me vetëbesim dhe të jenë tërheqës për të tjerët:

- duke përdorur gjuhën standarde, sidomos kur këtë e dikton situata dhe dëgjuesit;
- duke diskutuar në grupe të vogla dhe të mëdha, duke marrë role të ndryshme në menaxhimin dhe në moderimin e diskutimeve dhe debateve, si dhe duke përfshirë e angazhuar të tjerët për të përmbushur afatet dhe qëllimet;

- duke respektuar, gjatë prezantimeve me gojë, karakteristikat e një fjalimi, shpjegimi, raportimi, debati etj.;
- duke përzgjedhur fjalët e fjalitë e përshtatshme dhe duke përdorur mjete retorike e të figurshme;
- duke përdorur dhe duke vlerësuar TIK-un gjatë prezantimeve në aktivitete të ndryshme në shkollë dhe jashtë saj.

2.3.1.2 FUSHA E TË NXËNIT “MATEMATIKË”

Për të përmbushur kërkesat që parashtron shoqëria dhe profesionet e ndryshme në epokën në të cilën jetojmë, nxënësi duhet të përshtatet me aftësinë për të përdorur matematikën dhe teknologjinë në mënyrë efektive, por edhe me aftësinë e përpunimit të sasive të mëdha të informacionit që merr si dhe me aftësinë për të nxënë në mënyrë të pavarur. Mësimi i matematikës në arsimin e mesëm të lartë synon që nxënësi të zhvillojë të menduarin logjik dhe kritik, të hulumtojë rreth koncepteve matematike dhe të zbulojë ngjashmëritë, ndryshimet, rregullsitë dhe marrëdhëniet shkak - pasojë ndërmjet dukurive, të zhvillojë imagjinatën dhe të zgjidhë situatat matematikore në mënyra të ndryshme, si dhe ***të jetë i motivuar për ta studiuar matematikën si fushë që ka rëndësi për jetën sociale dhe profesionale.***

Matematika mundëson zhvillimin e personalitetit të nxënësit, zhvillimin e aftësive të tij për të menduar në mënyrë kritike, për të hulumtuar, duke nxitur kështu kërshërinë dhe inkurajimin për zbulime, vetbesimin për zgjidhjen e situatave problemore në jetën e përditshme.

Lënda e matematikës është në funksion të përgatitjes së nxënësve për studime të mëtejshme ose për në tregun e punës. Mundësitë që krijon lënda e matematikës për integrimin me fushat e tjera dhe zbatimin e saj në këto fusha e nxisin nxënësin të jetë i interesuar dhe të kuptojë rëndësinë e saj për mundësitë në karrierë.

2.3.1.3 FUSHA E TË NXËNIT “SHOQËRIA DHE MJEDISI”

Në shkallën e pestë dhe të gjashtë, fusha “Shoqëria dhe mjedisi” integron njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera nëpërmjet lëndëve: Histori, Gjeografi, Qytetar, Filozofi dhe Ekonomi si lëndë të kurrikulës bërthamë, dhe lëndëve Sociologji, Psikologji në kurrikulën me zgjedhje.

Fusha e të nxënit “Shoqëria dhe mjedisi” u krijon nxënësve mundësitë të zhvillojnë kompetencat e nevojshme për të përmbushur rolin e tyre si anëtarë të një shoqërie shumëkulturore dhe demokratike në një botë gjithnjë e më të ndërvarur.

Në mënyrë të veçantë ***lënda e Qytetarisë, në filozofinë, qëllimin dhe praktikën e saj është e lidhur ngushtë me edukimin për karrierën.*** Përmes kësaj lënde nxënësit marrin njohuri për legjislacionin, jo vetëm duke u njohur me përmbajtjen e ligjit por duke u aftësuar dhe për interpretimin e tij.

Në funksion të orientimit të tyre për arsimimin e mëtejshëm dhe të vazhdueshëm, programi i kësaj lënde përfshin njohuri dhe zhvillon aftësi në lidhje me arsimimin si e drejtë themelore, Ligjin për arsimin parauniversitar, Institucionet shkollore, roli dhe përgjegjësitë e tyre për të garantuar të drejtën për arsim për të gjithë. Në këtë mënyrë lënda ofron mundësi që nxënësi të përdorë njohuritë dhe mjetet e tjera që ofron shkolla për të bërë zgjedhje për vazhdimësinë e arsimimit të tij.

Me fokus të veçantë lënda e Qytetarisë njeh nxënësin me legjislacionin për punën dhe të drejtën e punës, duke orientuar dukshëm edukimin e tyre për karrierën. Njohja e legjislacionit të punës konsiderohet e rëndësishme në karrierën e tyre të ardhshme për mbrojtjen e tyre si punëmarrës.

Tabela e mëposhtme paraqet rezultatet e të nxënësve të programit të Qytetarisë në klasën e 10-të, për punën dhe të drejtën e punës.

Njohuritë	Aftësitë
<ul style="list-style-type: none"> ✧ Kushtetuta për të drejtën e punës. ✧ Kodi i Punës dhe mbrojtja e interesave të punonjësit. ✧ Roli i legjislacionit të punës në mbrojtjen e të drejtave të punonjësve. ✧ Të drejtat e punonjësve. Mënyrat e mbrojtjes së tyre. ✧ Kontrata e punës. Kuptimi i kontratës së punës. Kushtet e lidhjes së kontratës së punës. Marrëveshja ndërmjet palëve. Shkaku i kontratës, objekti i saj. Forma e kontratës. Llojet e kontratave të punës. ✧ Kushtet e punës. Kuptimi i kushteve të punës. ✧ Mbrojtja në punë. Detyrimet e punëmarrësit për të siguruar mbrojtjen në punë. Mbrojtja e veçantë e të miturve në punë. ✧ Koha e punës. Koha e lejes dhe pushimit. ✧ Zgjidhja e kontratës dhe humbja e punës. Kuptimi i zgjidhjes së kontratës. Rastet e zgjidhjes së kontratës. Zgjidhja e kontratës pa shkaqe të arsyeshme. Zgjidhja e kontratës për shkaqe të arsyeshme. Afati i zgjidhjes së kontratës. ✧ Sigurimi shoqëror. Kuptimi mbi sigurimin shoqëror. Sigurimi shoqëror në legjislacionin shqiptar. Sigurimi shoqëror dhe interesat aktuale dhe perspektive të 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✧ jep një përcaktim të termave punë dhe punoj; ✧ rendit lloje të ndryshme punësh; dallon faktorët kryesorë që mundësojnë një proces prodhues; ✧ tregon përgjegjësinë e shtetit për punën; rendit të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve sipas legjislacionit shqiptar për punën; rendit disa nga hapat e domosdoshëm për të kërkuar punë; përshkruan tablonë e disa prej ndryshimeve kryesore që ka pësuar bota e punës në shoqërinë shqiptare dhe pasojat e tyre për botën e punës në Shqipëri; ✧ përshkruan disa nga tiparet kryesore të botës së punës në Evropë dhe kërkesat që shtron ajo për të rinjtë shqiptarë që dëshirojnë të jetojnë në të; ✧ diskuton për disa nga dukuritë, me të cilat ndeshen emigrantët shqiptarë në botën e punës jashtë Shqipërisë; ✧ mbledh fakte e të dhëna për problemet e punës së fëmijëve e të bëmë interpretimin e tyre; ✧ parashikon pasoja në aspekte të ndryshme të jetës së fëmijës qëndrime ose praktika të caktuara që lidhen me punën e fëmijëve në familje ose në shoqëri; ✧ përshkruan disa nga të drejtat e tij në punë dhe mënyrat e mbrojtjes së tyre; diskuton për rëndësinë e legjislacionit të punës për mbrojtjen e interesave dhe të

<p>punonjësve.</p> <ul style="list-style-type: none">✧ Sigurimi shoqëror dhe realiteti shqiptar.	<p>drejtave të punonjësve;</p> <ul style="list-style-type: none">✧ jep përkufizimin e kontratës sipas legjislacionit dhe të përshkruajë elementët e saj;✧ rendit disa nga hapat e domosdoshëm për mbrojtjen e interesave të tij në punë.
--	---

Një ndër synimet kryesore që përcakton programi mësimor i **Gjeografisë** në shkallën e pestë dhe më tej, **është të zhvillojë orientimin për karrierat që lidhen me fushën e studimit të gjeografisë dhe specializimeve më të ngushta të kësaj dege, të tilla si profesioni i gjeografit, meteorologut, sizmologut etj.**

Në lëndën e Psikologjisë nxënësit njihen me profesionin e psikologut, mundësitë e karrierës në këtë fushë dhe aplikimet profesionale të shkencës psikologjike.

Lënda e Ekonomisë, merr një rëndësi të veçantë në kurrikulën bërthamë të gjimnazit për vetë rolin e saj si një lëndë që zhvillon te nxënësit "mendimin ekonomik" ose "të menduarin ekonomik" si një ndër aftësitë kryesore të menaxhimit të karrierës për çdo individ, pavarësisht fushës apo profesionit që zgjedh të zhvillojë.

Përvetësimi i njohurive ekonomike bëhet në mënyrë graduale nëpërmjet procesit të krijimit të aftësive të nevojshme të nxënësve, ndërgjegjësimit për rolin e tyre si agjentë ekonomikë, si politikëbërës dhe vendimmarrës aktivë të çështjeve ekonomike.

Nxënësit mësojnë që planifikimi dhe menaxhimi janë shumë të rëndësishëm për të pasur financa të shëndetshme personale. Ata mësojnë të analizojnë ngjarjet, çështjet kryesore të jetës të cilat ndikojnë në financat e tyre personale. Po kështu ata njohin elementet themelore të financave të tyre personale dhe zbatojnë njohuritë dhe aftësitë e fituara në planifikimin e financave të tyre. **Duke zhvilluar përbërësit thelbësorë të një plan biznesi, nxënësit nxiten që të fillojnë një aktivitet sipërmarrjeje.** Duhet theksuar se kjo tematikë nuk del jashtë kufijve arsimorë dhe të një përvoje arsimore. Po kështu, kjo

tematikë nuk synon të japë këshilla të caktuara biznesi, financiare ose profesionale për nxënësit për të ndërmarrë nisma personale.

Nxënësi:

- ✧ përshkruan karakteristikat dhe praktikat e sipërmarrjes së suksesshme;
- ✧ vlerëson një ide sipërmarrëse, duke u bazuar tek produkti, klienti dhe në kriteret e avantazhit konkurrues;
- ✧ demonstroi aftësitë e planifikimit të biznesit për ngritjen e një sipërmarrjeje, për marketimin, financimin, menaxhimin dhe vendimmarrjen etike;
- ✧ vlerëson pasojat afatshkurtra dhe afatgjata të marrjes së vendimeve etike.

2.3.1.4 FUSHA E TË NXËNIT “SHKENCAT E NATYRËS”

Fusha e shkencave të natyrës në arsimin e mesëm të ulët integron njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera nëpërmjet lëndëve: Kimi, Fizikë, Biologji.

Në këto shkallë nxënësit zgjerojnë fushën e njohjes për dukuritë më të zakonshme në jetën dhe veprimtaritë e përditshme, zhvillojnë aftësitë, strategjitë dhe shprehjet e të menduarit të nevojshme për hetimin shkencor dhe skicimin teknologjik, lidhin njohuritë shkencore dhe teknologjike me njëra-tjetrën dhe me jetën, përdorin gjuhën dhe terminologjinë shkencore, si dhe krijojnë bazat konceptuale për të nxënësit e mëtejshëm të shkencës.

Vlen të theksohet fakti që, nisur dhe nga natyra e lëndëve të shkencave të natyrës, elementët e orientimit për karrierën në këtë fushë janë më të kufizuara në përmbajtjen dhe kompetencat lëndore, por ato zhvillohen kryesisht përmes rezultateve të të nxënësit të kompetencave kyçe.

2.3.1.5 FUSHA E TË NXËNIT: TEKNOLOGJI DHE TIK

Për të marrë pjesë në një ekonomi të bazuar në dije dhe për të qenë të fuqishëm në një shoqëri teknologjike të sofistikuar për të sotmen dhe në të ardhmen, nxënësve u nevojiten njohuri, aftësi dhe besim në TIK për të realizuar detyrat në shkollë, shtëpi, punë dhe në komunitetet e tyre. Si qytetarë, ata duhet të jenë të aftë të bëjnë gjykime vetjake mbi çështjet që lidhen me ndikimin e teknologjisë në jetët e tyre, në shoqëri dhe në mjedis.

Lënda e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) zhvillon te nxënësit aftësi të rëndësishme për jetën dhe për zhvillimin e karrierës së tyre. Sot TIK -u përshkon të gjitha aspektet e jetës, duke siguruar mënyra të reja, më të mira dhe më të shpejta për njerëzit që të ndërveprojnë, të rrjetëzojnë, të kërkojnë ndihmë, të kenë akses në informacion dhe të mësojnë. Në kohët e sotme, Teknologjia dhe TIK-u janë kthyer në një mënyrë jetese, me të cilën fëmijët dhe të rinjtë ndeshen që në vitet e para të jetës. Në një botë, ku ndeshesh me shumë lloje teknologjish, të cilat janë pjesë e jetës së përditshme për të gjithë njerëzit, kjo fushë ndihmon që nxënësit të pajisen me aftësi për t'u përballur me to, me vetëbesim, aftësohen të bëjnë gjykime vetjake mbi çështjet që lidhen me ndikimin e teknologjisë në jetët e tyre, në shoqëri dhe në mjedis.

Kjo lëndë synon të kontribuojë në një edukim të balancuar, duke iu dhënë nxënësve një përvojë të gjerë dhe sfiduese, që u krijon mundësi atyre të fitojnë një grup njohurish, kuptimesh, aftësish njohëse e përpunuese dhe kompetenca të thjeshta, duke i përgatitur në këtë mënyrë që të jenë pjesëmarrës në një botë teknologjike.

Nxënësit mësojnë të përdorin TIK për të kërkuar informacion, për të kryer detyra që u ngarkohen, për të prezantuar punime dhe produkte të punës së tyre, për zhvilluar programe etj.

2.3.1.6 FUSHA E TË NXËNIT: EDUKIM FIZIK, SPORTE DHE SHËNDETI

Fusha mësimore “Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti” ka si qëllim të shihet si një mjet për promovimin e veprimtarisë së rregullt fizike, edukimin e një stili jetese të shëndetshme e aktive dhe fitimin e kompetencave të rëndësishme e të vlefshme përgjatë gjithë jetës.

Nëpërmjet këtyre lojërave sportive (basketboll, volejball, futboll,etj.), nxënësit krijojnë e fitojnë kompetenca shumë të rëndësishme për jetën, zhvillojnë më tej cilësitë fizike, aftësitë e komunikimit dhe të punuarit në skuadër, duke e konsideruar sportin si mundësi për karrierë, zhvillojnë aftësitë për pranimin dhe ndarjen e përgjegjësisë, si dhe gëzimin e suksesit, mësohen të respektojnë rregullat e lojës dhe fair-play-t në aktivitetet sportive në shkollë e jashtë saj, që në vetvete përbën një model të respektit ndaj rregullave demokratike të jetës qytetare, si dhe formimin e kulturës së të ushtruarit sportiv për gjatë gjithë jetës.

Duke marrë pjesë në procesin mësimor të edukimit fizik dhe sporte, një nxënës ka filluar të mësojë shumë gjëra për jetën. Ai fiton në disa lojëra dhe humbet në disa të tjera, kjo e bën atë të kuptojë se fitorja dhe humbja janë një pjesë e jetës dhe duhet të pranohen si të tilla. Kur një nxënës bëhet pjesë e një ekipi, ai mëson se bashkëpunimi me të tjerët është shumë i rëndësishëm në qoftë se duhet të arrihen qëllimet. Duhet të respektohen rregullat e lojës, vendimet e gjyqtarit dhe kundërshtari. Gjithashtu, pjesëmarrja në praktika lëvizore e sportive mundëson zhvillimin mendor e intelektual të nxënësve në mënyrë argëtuese dhe të drejtpërdrejtë.

Në arsimin e mesëm të lartë, krahas formës kroskurrikulare përmes përfshirjes në lëndë të ndryshme të rezultateve të të nxënësve që nxisin orientimin për karrierën, në kurrikulën me zgjedhje modulet profesionale sikurse dhe disa prej moduleve lëndore, kanë si qëllim zhvillimin e kompetencave profesionale sikurse dhe zhvillimin e njohurive dhe aftësive kyçe jetësore , sipërmarrëse dhe ndërprofesionale.

Modulet profesionale që orientojnë nxënësit drejt profesioneve përfshijnë: 1. Punime të mirëmbajtjes dhe riparimit në banesa; 2. Etika e të veshurit dhe arredimit; 3. Veprimtari në shërbimin e klientit; 4. Estetika dhe truku; 5. Veprimtaritë bujqësore; 6. Veprimtaritë ndihmëse në laborator; 7. Asistencë zyre; 8. Përpunim i produkteve ushqimore; 9. Punime të riparimit dhe mirëmbajtjes mekanike. 10. Guida turistike.

Modulet lëndore që krijojnë premisa për një orientim më të mirë të nxënësve për sipërmarrjet dhe karrierën e tyre të ardhshme përfshijnë: 1. Drejtues për një ditë; 2. Kompania e nxënësve; 3. Edukimi financiar; 4. Parandalimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mjedise pune.

Në mënyrë të veçantë moduli "Edukimi për karrierën", si një modul lëndor në kurrikulën me zgjedhje të arsimit të mesëm të lartë, është tërësisht me fokus orientimin e nxënësve për karrierën.

2.3.1.7 MODULI LËNDOR: EDUKIM PËR KARRIERËN

Moduli "Edukim për karrierën", është një modul lëndor i dedikuar tërësisht në funksion të orientimit të nxënësve për karrierën, i cili ofrohet në të gjitha klasat e gjimnazit si pjesë e kurrikulës me zgjedhje. Lënda zhvillohet me 1 orë mësimore/javë ose 36 orë mësimore vjetore.

Nëpërmjet kësaj lënde nxënësit identifikojnë dhe hulumtojnë qëllimet e karrierës, zbatojnë aftësitë e komunikimit dhe mendimin kritik, zhvillojnë aftësitë punë kërkuese dhe planifikojnë, marrin vendim për shkollimin, trajnimin e mëtejshëm dhe punësimin.

Lënda thekson se formimi i karrierës është një proces që zgjat gjatë gjithë jetës. Ai fillon në familje, zhvillohet gjatë periudhës së shkollimit si dhe përvojave të punës dhe shfaqet, njehsohet me aftësinë e individit për të marrë vendime për të ardhmen e tij, në përshtatje me statusin e kualifikimit dhe me ndryshimet e tregut të punës.

Nëpërmjet kësaj lënde synohet të zhvillohen te nxënësit aftësitë për të zbuluar mundësitë e karrierës, si dhe për të vetëvlerësuar interesat dhe prirjet me qëllim vendimmarrjen për shkollimin/trajnimin e mëtejshëm dhe punësimin, për të qenë pjesëtarë funksionalë të shoqërisë.

Kjo lëndë fokusohet në dy fusha, atë të edukimit për karrierë dhe sipërmarrjen. Programi i kësaj lënde zhvillohet mbi bazën e tre rezultateve kryesore të të nxënësve, të cilat përfshijnë fushat e mëposhtme:

- Hulumtimi i karrierës;
- Vetëvlerësimi;
- Vendimmarrja për karrierën.

Programi përfshin një numër konceptesh bazë mbi të cilat mbështetet zhvillimi i modulit "Edukimi për karrierën":

- punë, llojet e punëve, profesion, fushë profesionale;
- karrierë, zhvillimi i karrierës; orientimi i karrierës, informimin e karrierës;
- punëdhënës, punëmarrës;
- arsim, arsim profesional, kualifikim profesional, trajnim;
- tregu i punës; sipërmarrës, ekonomi globale, performancë.
- vetëvlerësim;
- stile të të nxënësve;
- aftësitë;
- vlerat në punë;
- tipet e personalitetit;
- grupe të interesave.
- intervistë për punë;
- kërkesë për punë;
- aplikim për punë;
- "curriculum vitae";
- plani i veprimit;

- analiza "SWOT";
- vlerësim; feed back.

Moduli "Edukimi për karrierë" zhvillon te nxënësi aftësi për të hulumtuar në lidhje me tregun e shkollimit dhe punësimit, aftësi për të vlerësuar veten dhe aftësi për të realizuar sipërmarrje bazuar në një plan të studiuar mirë.

2.4 LEGJISLACIONI PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR DHE HAPËSIRAT QË SIGURON PËR ORIENTIMIN PËR KARRIERËN

Në lidhje me "Legjislacionin për arsimin parauniversitar" kërkimi është fokusuar në identifikimin e hapësirave që mundëson dhe siguron legjislacioni për arsimin parauniversitar dhe aktet e tjera nënligjore, në lidhje me orientimin e nxënësve për karrierën dhe çështjet që lidhen me të.

Objekti i kërkimit është:

- *Ligji "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" Nr.69/2012, i ndryshuar.*
- *Rregullorja e funksionimit të institucioneve arsimore të arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.*
- *Urdhri për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet arsimore parauniversitare dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social.*

Ligji Nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në qëllimet e tij e shpreh qartë synimin e sistemit arsimor për aftësimin e nxënësve për jetën dhe punën, zhvillimin e shpirtit të sipërmarrjes dhe përdorimin e teknologjive të reja.

Dy nenet e veçanta të ligjit, neni 22 për arsimin bazë, dhe neni 23 për arsimin e mesëm të lartë kanë përcaktuar si një ndër synimet e këtyre niveleve arsimore dhe përgatitjen e nxënësve për të kaluar nga një nivel arsimor në tjetrin, për vazhdimin e arsimimit të mëtejshëm apo hyrjen në tregun e punës.

Neni 22, Arsimi bazë:

1. Arsimi bazë synon zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo nxënësi, zotërimin e rregullave të sjelljes dhe kultivimin e vlerave, përkujdesjen për shëndetin, si dhe *përgatitjen e mjaftueshme për vazhdimin e arsimit të mesëm të lartë ose për tregun e punës.*

Neni 23, Arsimi i mesëm i lartë:

Arsimi i mesëm i lartë synon zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave të fituara nga arsimi bazë, konsolidimin e individualitetit të çdo nxënësi dhe tërësinë e vlerave e të qëndrimeve, *zgjerimin dhe thellimin në fusha të caktuara të dijes, përgatitjen për arsimin tretësor ose për tregun e punës.*

Rregullorja e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë përmban një nen të posaçëm për orientimin e nxënësve për karrierën. Ky nen thekson detyrimin e drejtorive të shkollave për organizimin e veprimtarive për orientimin e nxënësve për karrierën në klasën e 9-të dhe të të 12-të, si dy momente të kalimit të nxënësve nga një nivel në tjetrin apo në tregun e punës. Vlen të theksohet që në lidhje me orientimin e nxënësve për karrierën rregullorja ndalet vetëm në këto dy momente të shkollimit dhe nuk përcjell detyrime për institucionet arsimore për vitet/klasat e tjera pararendëse.

Neni 79, Orientimi i nxënësve për karrierën e tyre:

Drejtorja e shkollës së arsimit bazë organizon me nxënësit e klasës së nëntë dhe personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të tyre:

- takime me punonjës arsimorë të shkollave të arsimit të mesëm të lartë;
- vizita në mjedise të mundshme për punësim.

1. Drejtorja e shkollës së arsimit të mesëm të lartë organizon me nxënësit e vitit të

fundit dhe me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të tyre:

- a) takime me pedagogë të degëve të institucioneve të arsimit të lartë;
- b) vizita në mjedise të mundshme për punësim.

Gjithashtu, Rregullorja përcakton në pikën 3, Neni 66/Kreu XII, detyrat e mësuesit kujdestar. Sipas kësaj pike, mësuesi kujdestar kujdeset posaçërisht për:

D) plotësimin e pëlqimeve të nxënësve për kurrikulën me zgjedhje;

E) këshillimin e nxënësve në zgjedhjet kurrikulare dhe zgjedhjet e karrierës.

- Përsa i takon rolit të shërbimit psiko-social në lidhje me orientimin për karrierën, **urdhri për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet arsimore parauniversitare** shprehet në terma të përgjithshëm se shërbimi psiko-social në institucionet arsimore planifikon dhe realizon shërbime që ndihmojnë në zhvillimin arsimor, social dhe personal të nxënësve. Dokumenti nuk e specifikon në mënyrë të veçantë si një funksion të këtij shërbimi, orientimin dhe këshillim e nxënësve për karrierën.

2.5 PRAKTIKAT DHE PËRVOJAT PËR ORIENTIMIN E NXËNËSVE PËR KARRIERËN NË INSTITUCIONET ARSIMORE PARAUNIVERSITARE

Analiza e situatës në lidhje me praktikat dhe përvojat e institucioneve arsimore për orientimin e nxënësve për karrierën synoi mbledhjen dhe interpretimin e të dhënave në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.

Të dhënat u siguruan përmes pyetësorëve të aplikuar me drejtues të institucioneve arsimore të arsimit bazë dhe të mesëm të lartë, si dhe përmes intervistave dhe bisedave të strukturuar me mësues kujdestarë, mësues të lëndëve të ndryshme, psikologë shkollorë dhe punonjës socialë.

Kampioni pjesëmarrës përfshiu 805 institucione arsimore parauniversitare në nivel kombëtar, të shpërndara në 4 Drejtori Arsimore Rajonale (DRAP) dhe 52 Zyra Vendore Arsimore (ZVAP).

Popullata e synuar për plotësimin e pyetësorit përfshiu institucionet arsimore të arsimit bazë dhe arsimit të mesëm të lartë, të shpërndara në zona urbane dhe rurale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas profileve të mëposhtme:

- Shkollë 9-vjeçare (AF+AMU)
- Gjimnaz
- Shkollë e mesme e bashkuar
- Shkollë e mesme me drejtim të orientuar gjuhësor
- Shkollë e mesme me drejtim të orientuar artistik
- Shkollë e mesme me drejtim të orientuar sportiv

Të dhënat e mbledhura u përpunuan nga ana statistikore me paketën statistikore SPPSS.


Raporti i analizës së të dhënave përfshin interpretime të gjetjeve në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe shtojcën të cilat përmbajnë të dhënat në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal. Të interesuarit për të dhëna dhe lexime të tjera në nivel më të ngushtë do të duhet ta konsultojnë më tej databazën e të dhënave e cila krijon shumë hapësirë për përpunime të mëtejshme. Databaza me të dhënat e mbledhura mund t'i shërbejë përdoruesve të interesuar për identifikimin e të dhëna të tjera të detajuara të vlefshme në nivel rrethi dhe institucioni arsimor.

2.5.1 Të dhëna të përgjithshme

✚ Numri i institucioneve arsimore të përfshira në analizë

Për të mundësuar mbledhjen e të dhënave në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, pyetësi iu shpërnda të gjitha institucioneve arsimore parauniversitare. Nga të dhënat e përfutuara rezultojnë që, në nivel kombëtar, janë siguruar të dhëna nga **805 institucione arsimore parauniversitare (afërsisht 70% e numrit total të institucioneve arsimore parauniversitare)**, të shpërndara në katër Drejtoritë Rajonale Arsimore Parauniversitare (DRAP). Bazuar në të dhënat dhe grafikun e shpërndarjes rajonale rezultojnë që numrin më të madh të institucioneve arsimore të përfshirë në analizë e ka DRAP Durrës (34%), i pasuar nga DRAP Korçë (29%), DRAP Fier (23%) dhe DRAP Lezhë (14%).


Grafiku 1. Shpërndarja e kampionit pjesëmarrës sipas Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar



✚ Numri i institucioneve arsimore (zona urbane/rurale)

Referuar të dhënave të tabelës dhe grafikut të mëposhtëm, rezultojnë që në nivel kombëtar ndër shkollat që janë përfshirë në analizë, numrin më të madh e përbëjnë shkollat në zonat rurale me rreth 57%, ndërsa 43% janë shkollat në zonat urbane.


Grafiku 2. Shpërndarja e shkollave sipas zonës së banimit



Numri i institucioneve arsimore sipas nivelit arsimor dhe profilit

Të dhënat e përfshira në grafikun e mëposhtëm tregojnë numrin dhe përqindjen e institucioneve arsimore sipas nivelit arsimor dhe profilit të shkollave, që janë përfshirë në analizë.

Grafiku 3. Shpërndarja e shkollave sipas profilit/llojit/drejtimi



Institucionet e arsimit bazë⁵ përbëjnë 64% të numrit të përgjithshëm të institucioneve që janë përfshirë në analizë (gjithsej 515 institucione arsimore të arsimit bazë); duke u pasuar nga gjimnazet të cilat përbëjnë rreth 18% të numrit të përgjithshëm të institucioneve të përfshira në analizë dhe shkollat e mesme të bashkuara me 17% (143 gjimnaze). Gjithashtu, pjesë e të dhënave dhe plotësimit të pyetësorit kanë qenë dhe 9 institucione arsimore të arsimit të orientuar (që përfshijnë shkollat artistike, sportive dhe të gjuhëve të huaja), si dhe 138 shkolla të mesme të bashkuara, të cilat përfshijnë klasa të arsimit bazë dhe të mesëm të lartë.

2.5.2 Gjetje nga të dhënat e institucioneve arsimore

Nga përpunimi dhe analiza e të dhënave sasiore dhe të dhënave cilësore janë identifikuar gjetjet e mëposhtme:


➤ Përfshirja në planet afatshkurtra dhe afatgjata të institucionit arsimor i veprimtarive për edukimin dhe orientimin e nxënësve për karrierën është një tregues i rëndësishëm në

⁵ Arsimi bazë përfshin arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët.

lidhje me zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e zbatimit të programeve për orientimin e nxënësve për karrierën nga institucionet arsimore.


Sikurse rezulton nga grafiku i mëposhtëm, **82% e institucioneve arsimore janë shprehur se kanë përfshirë në planin afatmesëm dhe vjetor të institucionit arsimor programe/veprimtari për orientimin e nxënësve për karrierën.**

Grafiku 4. Shkolla ka përfshirë veprimtari për orientimin e nxënësve për karrierën në planin afatmesëm, vjetor ose në ndonjë plan tjetër të veprimtarive të institucionit arsimor.



Nga të dhënat e grafikut të mëposhtëm rezulton se **96% e institucioneve arsimore (769) janë shprehur se kanë organizuar veprimtari për orientimin për karrierën dhe ofrojnë mbështetje për nxënësit në këtë drejtim.**


Grafiku 5. Institucioni juaj arsimor ofron mbështetje dhe ka organizuar veprimtari për edukimin dhe orientimin e nxënësve për karrierën.



Nga këto 769 institucione arsimore që janë shprehur pozitivisht, 433 institucione arsimore janë në zonat rurale dhe 463 institucione arsimore i përkasin arsimin bazë, e lidhur kjo dhe me faktin se këto institucione përbëjnë dhe numrin më të madh të shkollave.

➤ Një ndër çështjet për të cilat u kërkua informacion nga institucionet arsimore, janë llojet e veprimtarive për orientimin për karrierën që shkollat zhvillojnë dhe zbatojnë. Në mënyrë që të orientonte përgjigjet e pjesëmarrësve, instrumenti u strukturua rreth disa fushave kryesore të veprimtarive sikurse u krijua mundësia që shkollat të përfshinin dhe lloje të tjera veprimtarish që ata zhvillojnë. Në lidhje me këtë tregues të dhënat rezultojnë si më poshtë:


Grafiku 6. Llojet e veprimtarive për orientimin për karrierën që shkollat zhvillojnë



Nga grafiku del qartë se **bisedat e lira me nxënës janë lloji i veprimtarive për orientimin për karrierën që zhvillojnë në pjesën më të madhe institucionet arsimore.** 761 nga 769 institucione arsimore janë shprehur se ndër veprimtaritë më të zakonshme që zhvillojnë për orientimin e karrierës janë bisedat me nxënës. Gjithashtu, **marrja e njohurive përmes lëndëve në tema të caktuara (si kroskurrikul) apo takimet me prindër të profesioneve të ndryshme rezultojnë ndër veprimtaritë që zhvillohen nga një numër më i madh shkollash; veprimtaritë që zhvillohen nga një numër më i vogël shkollash rezultojnë të jenë këshillimet online dhe panairët e karrierës.**

➤ Angazhimi i mësuesve, drejtuesve, psikologëve shkollorë, punonjësve socialë, i vetë nxënësve por dhe i prindërve si partnerët më të interesuar dhe më të afërt të shkollës për orientimin e nxënësve për karrierën, është një komponent kyç për planifikimin dhe zhvillimin e veprimtarive të institucioneve arsimore në lidhje me edukimin, informimin dhe këshillimin e nxënësve për karrierën.

Grafiku 7. Për zhvillimin e veprimtarive të orientimit për karrierën angazhohet më shumë:



Nga të dhënat e grafikut të mësipërm, rezultojnë se pjesa më e madhe e institucioneve arsimore janë shprehur se ***drejtuesi i institucionit arsimor është personi më i angazhuar për realizimin e veprimtarive për orientimin e nxënësve për karrierën, pasuar nga mësuesi kujdestar dhe mësuesit e lëndëve; psikologu dhe në mënyrë më të dallueshme punonjësi social rezultojnë që angazhohen në një numër më të vogël shkollash në këtë drejtim.***

Vlen të theksohet që në të gjitha praktikat dhe përvojat e institucioneve arsimore për orientimin për karrierën, ***roli i drejtuesit të institucionit arsimor*** për planifikimin dhe menaxhimin e veprimtarive dhe të shërbimeve që ofron shkolla, është thelbësor. Risjellim në vëmendje faktin që legjislacioni për arsimin bazë dhe për arsimin e mesëm të lartë ngarkon në mënyrë të drejtpërdrejtë drejtorin e institucionit arsimor me detyrën për të organizuar veprimtaritë që mbështesin orientimin e nxënësve për karrierën, në mënyrë të veçantë në klasën e 9-të dhe në klasën e 12-të.

Mësuesi kujdestar është mësuesi më i angazhuar dhe më pranë nxënësve në lidhje me njohjen e interesave, nevojave, arritjeve, background-it të tyre familjar dhe social. Gjithashtu, legjislacioni për arsimin përcakton në një nen të veçantë detyrimin që ka mësuesi kujdestar për këshillimin e nxënësve në zgjedhjet kurrikulare dhe zgjedhjet e karrierës. Po kështu, orët e kujdestarisë sigurojnë hapësirën dhe mundësitë që mësuesi

kujdestar të planifikojë dhe të zhvillojë tema të veçanta dhe veprimtari për të realizuar këshillimin e nxënësve për karrierën. ***Nga bisedat me mësues kujdestarë dhe nga të dhënat cilësore rezulton e nevojshme zhvillimi i kapaciteteve të mësuesve kujdestarë për të zhvilluar cilësisht orientimin e nxënësve për karrierën, përmes mbështetjes me materiale burimore dhe trajnime të vazhdueshme.***

Përfshirja në programet mësimore të të gjitha lëndëve e rezultateve të të nxënësve të kompetencave kyç, përfshirë rezultatet që nxisin zhvillimin e aftësive për menaxhimin e karrierës, përcjell te ***mësuesit e lëndëve të ndryshme*** detyrimin për t'i realizuar ato. Rezulton e nevojshme mbështetja e mësuesve në lidhje me metodologjinë e zhvillimit të këtyre aftësive.

Përsa i takon angazhimit të ***psikologëve dhe punonjësve socialë*** në orientimin e nxënësve për karrierën, në numër më të vogël shkollat janë shprehur për përfshirjen e tyre në këtë proces. Psikologët dhe punonjësit socialë janë dy aktorë të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve për këshillimin dhe orientimin e nxënësve për karrierën.


➤ ***Klasat në të cilat shkollat zhvillojnë më së shumti veprimtari për orientimin për karrierën rezultojnë të jenë klasa 8, 9 dhe 12, si momente të rëndësishme të kapërcimit nga një nivel në tjetrin.***

Tabela 1. Klasa në të cilën zhvillohen më shumë veprimtaritë për orientimin e nxënësve për karrierën.

Klasa	Po	Jo
Klasa I	82	723
Klasa II	79	726
Klasa III	91	714
Klasa IV	119	686
Klasa V	217	588
Klasa VI	254	551
Klasa VII	287	518
Klasa VIII	462	343
Klasa IX	671	134
Klasa X	308	497
Klasa XI	375	430
Klasa XII	404	401

➤ Është e njohur dhe e gjithëpranuar lidhja që ekziston ndërmjet orientimit për karrierën dhe reduktimit të braktisjes së shkollës lidhur kjo me mundësitë që programet e orientimit për karrierën krijojnë për nxënësit, duke mundësuar që ata të zbulojnë dhe zhvillojnë aftësitë dhe prirjet e tyre, si dhe të kuptojnë dhe eksplorojnë mundësitë që u ofrohen në fusha të ndryshme punësimi apo aktivitete të tjera.

Grafiku 8. Veprimtaritë për orientimin e nxënësve për karrierën që zhvillohen në shkollë integrohen me planet për parandalimin e braktisjes së shkollës.



Sikurse rezulton nga grafiku, **66% e institucioneve arsimore janë shprehur se veprimtaritë që ato zhvillojnë për orientimin e nxënësve për karrierën integrohen me planet për parandalimin e braktisjes së shkollës; 30% shprehen "pak", dhe 4% janë shprehur "aspak".**

Krahas përvojave që shkollat kanë zhvilluar në lidhje me orientimin për karrierën, përmes instrumenteve të përdorura u synua të mblidhen dhe sugjerimet e tyre për përmirësimin e punës së tyre në këtë drejtim.

➤ Në lidhje me format e edukimit për karrierën që sigurojnë më shumë efektivitet në punën me nxënësit, referuar sugjerimeve të dhëna nga shkollat, rezultojnë të dhënat e mëposhtme, të pasqyruara në tabelën 11.

Tabela 2. Format e organizimit kurrikular që konsiderohen si forma më të përshtatshme për të realizuar edukimin e nxënësve për karrierën.


Format e organizimit kurrikular	Nr.shkollave që janë shprehur pozitivisht
Përmes veprimtarive në orët e kujdestarisë.	693
Forma kroskurrikulare (përmes njohurive në lëndë të ndryshme, si p.sh., në lëndën e Gjuhës Shqipe nxënësit mësojnë të shkruajnë një letër aplikimi për një vend pune).	685
Përmes veprimtarive ekstrakurrikulare, si p.sh., Java e	591

karrierës etj.	
Si lëndë/modul i veçantë.	564

➤ Këshillimi për karrierën është një ndër veprimtaritë që siguron mbështetje të rëndësishme për zgjedhjet dhe vendimmarrjet e nxënësve. Realizimi i tij kërkon mësues dhe psikologë/punonjës socialë me përgatitjen e duhur profesionale.

Pjesa më e madhe e shkollave, 44% "dakord" dhe 21 % "shumë dakord", janë shprehur se këshillimi online për karrierën siguron mbështetje për nxënësit, duke mundësuar që nga ky shërbim të përfitojnë një numër më i madh nxënësish.


Grafiku 9. Këshillimi online për karrierën siguron mbështetje për nxënësit, duke mundësuar që nga ky shërbim të përfitojnë një numër më i madh nxënësish.



➤ Në lidhje me angazhimin e anëtarëve të stafeve mësimore, shkollat janë shprehur se në mënyrë të veçantë ***mësuesi kujdestar (707 institucione arsimore të shprehura pozitivisht)*** si dhe ***një mësues i specializuar për edukimin dhe orientimin e nxënësve për karrierën (720 institucione arsimore të shprehura pozitivisht)***, janë personat që mund të sigurojnë mbështetje më të kualifikuar për orientimin e nxënësve për karrierën. Një mësues i specializuar për orientimin për karrierën siguron ekspertizën e nevojshme për realizimin e këtij shërbimi dhe veprimtarive në përmbushje të tij, por përgatitja e tij kërkon mbështetje të veçantë për zhvillimin e tij profesional.

Grafiku 10. Anëtarët e stafit mësimor të shkollës që mund të sigurojnë mbështetje më të kualifikuar për orientimin e nxënësve për karrierën.

Raport i analizës së orientimit të nxënësve për karrierën në arsimin parauniversitar



➤ Nga të dhënat cilësore rezulton që shkollat e shohin mjaft të nevojshme **mbështetjen për zhvillimin profesional të mësuesve, të drejtuesve, të psikologëve dhe punonjësve socialë për orientimin e nxënësve për karrierën**. Mbështetja me trajnime dhe materiale burimore deri më tani rezulton e pamjaftueshme në këtë drejtim.

3 GJETJE

Nga analiza e kurrikulës së arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë, referuar dokumenteve të politikës kurrikulare dhe programeve mësimore të të gjitha lëndëve dhe klasave, nga shqyrtimi i legjislacionit për arsimin parauniversitar dhe nga vlerësimi i të dhënave të mbledhura në nivel kombëtar nga institucionet arsimore parauniversitare për orientimin e nxënësve për karrierën, janë identifikuar gjetjet e mëposhtme:

▪ **Nga shqyrtimi i kurrikulës dhe i dokumenteve kurrikulare** rezulton se, qasja filozofike e kurrikulës bazuar në kompetenca, e cila përshkon çdo fushë të nxëni në arsimin bazë dhe në arsimin e mesëm të lartë, konsideron si fokus të formimit të nxënësve, zhvillimin e kompetencave kyçe. ***Këto kompetenca synojnë të zhvillojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime që i aftësojnë fëmijët dhe të rinjtë të planifikojnë dhe të menaxhojnë karrierën e tyre:*** të zhvillojnë personalitetin; të nxënë dhe të marrin pjesë aktive në shoqëri; të zhvillojnë aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese, aftësi të nevojshme për vendimmarrje të mirëmenduar; të zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes dhe të jenë të motivuar për të përmbushur objektivat; të përdorin kompjuterin për të gjetur, prodhuar, krijuar, prezantuar dhe shkëmbyer informacion si dhe për të bashkëpunuar në rrjetet informuese në internet etj.

▪ **Kurrikula e arsimit parauniversitar është e organizuar në gjashtë shkallë. Në mënyrë të veçantë shkalla e katërt (klasat 8-9) e kurrikulës “Përforcim i arritjeve dhe orientim në karrierë” dhe shkalla e gjashtë (klasa 12) “Konsolidim i arritjeve dhe specializim” kanë në fokus orientimin e nxënësve për karrierën, e lidhur kjo me kalimin nga klasa e 9-të në arsimin e mesëm të lartë dhe me kalimin nga arsimit i mesëm i lartë në arsimin universitar ose në tregun e punës.** Vlen të theksohet që megjithëse në këto dy shkallë orientimi për karrierën merr një vëmendje të veçantë, ndërhyrja për orientimin për karrierën e shprehur qartë nis që në shkallën e tretë “Zhvillimi i mëtejshëm i bazave dhe orientim”.

▪ Në **arsimin fillor (klasat 1-5)** dhe **në arsimin e mesëm të ulët (klasat 6-9)** edukimi për karrierën zhvillohet kryesisht përmes qasjes kroskurrikulare. Kjo nënkupton që në programet mësimore të të gjitha lëndëve janë përfshirë rezultate të nxëni të kompetencave kyçe dhe lëndore që synojnë edukimin e nxënësve për karrierën. Kompetencat kyç përfshijnë rezultate të nxëni të cilat synojnë që nxënësit të zhvillojnë aftësitë bazë të menaxhimit të karrierës, si njohjen e dëshirave, mundësive dhe nevojave të tyre, kuptimin e përgjegjësisë për veten dhe për të tjerët, të mësojnë për rëndësinë e çdo profesioni, të orientohen për dëshirat e tyre për të ardhmen, për rëndësinë që ka shkollimi dhe të mësuarit për pajisjen e tyre me njohuritë dhe aftësitë që kërkojnë profesionet që ata dëshirojnë të bëjnë në të ardhmen, sikurse të zhvillojnë aftësi të vetëvlerësimit, të zgjidhjes së problemeve, mbajtjes së qëndrimit kritik ndaj zgjidhjes së tyre dhe aftësi të vendimmarrjes së mirëmenduar. Në mënyrë të veçantë, lënda e Qytetarisë përmes njohurive, aftësive dhe qëndrimeve që zhvillon, orienton nxënësit të fillojnë të mendojnë për dëshirat e tyre në të ardhmen, pasqyron lidhjen e profesioneve me llojet e punëve që plotësojnë nevojat dhe dëshirat e nxënësve etj.

Është e nevojshme që mësuesit të mbështeten me udhëzime metodologjike dhe modele veprimtarish për mënyrën se si të zhvillojnë përmes lëndëve të tyre këta elementë të edukimit për karrierën, pasi mbështetja e tyre në këtë drejtim deri më tani është e pamjaftueshme.

▪ Krahas hapësirës dhe mundësive që krijojnë lëndët mësimore në arsimin bazë, hapësira e kurrikulës në bazë shkolle në klasat 6-9, me 1 orë mësimore/javë, përbën një hapësirë kurrikulare ku shkollat aktualisht zhvillojnë module për fusha të ndryshme që lidhen me formimin qytetar të nxënësve dhe që përmbushin interesat e nevojat e tyre. **Nga përvojat e mëparshme rezulton se në klasën e 9-të është zhvilluar si pjesë e kurrikulës me zgjedhje një modul për orientimin e nxënësve për karrierën, përvojë nga e cila rezultoi si e domosdoshme përgatitja e mësuesit që do të zhvillonte këtë modul.**

Kurrikula në bazë shkolle, në mënyrë të veçantë në klasat 7-9 mund të shfrytëzohet për të zhvilluar module/veprimtari që nxisin zhvillimin e aftësive të menaxhimit të karrierës dhe mundësojnë orientimin dhe këshillimin e nxënësve për karrierën.

▪ Gjithashtu, **veprimtaritë esktrakurrikulare përtej orarit mësimor mundësojnë zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme** për edukimin dhe këshillimin për karrierën, me pjesëmarrjen dhe të anëtarëve të tjerë të komunitetit.

▪ Në **arsimin e mesëm të lartë (klasat 10-12)**, edukimi për karrierën zhvillohet si qasje e kombinuar:

- **Përmes formës kroskurrikulare, e integruar përmes lëndëve të ndryshme.** Në mënyrë të veçantë, **lënda e Qytetarisë dhe e Ekonomisë përfshijnë njohuri dhe zhvillojnë aftësi që nxisin edukimin për karrierën.**

- **Si modul i veçantë kurrikular në kurrikulën me zgjedhje, i titulluar "Edukim për karrierën".** Moduli "Edukim për karrierën", është një modul lëndor i dedikuar **tërësisht në funksion të orientimit të nxënësve për karrierën.** Nëpërmjet kësaj lënde nxënësit identifikojnë dhe hulumtojnë qëllimet e karrierës, zbatojnë aftësitë e komunikimit dhe mendimin kritik, zhvillojnë aftësitë punë kërkuese dhe planifikojnë, marrin vendim për shkollimin, trajnimin e mëtejshëm dhe punësimin. Moduli ofrohet në të gjitha klasat e gjimnazit duke krijuar mundësi që nxënësit ta zgjedhin që në klasën e 10-të, sikurse dhe në klasat e mëvonshme.

- **Në kurrikulën me zgjedhje ofrohen 12 module profesionale sikurse dhe module lëndore që kanë si qëllim zhvillimin e kompetencave profesionale, zhvillimin e njohurive dhe aftësive kyçe jetësore, të aftësive sipërmarrëse dhe ndërprofesionale.**

- **Kurrikula në bazë shkolle me 0-2 mësimore/javë, krahas orëve të kujdestarisë, është një hapësirë kurrikulare ku shkollat aktualisht zhvillojnë module/veprimtari për tema të ndryshme, në përmbushje të interesave dhe nevojave të nxënësve. Kjo hapësirë mund të shfrytëzohet për të zhvilluar tema/veprimtari/module për orientimin e nxënësve për karrierën.**
- **Veprimtaritë esktrakurrikulare përtej orarit mësimor mundësojnë zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për edukimin dhe këshillimin për karrierën, me pjesëmarrjen dhe të anëtarëve të tjerë të komunitetit.**
- **Nga shqyrtimi i legjislacionit për arsimin parauniversitar, rezulton se Rregullorja e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë përmban një nen të posaçëm për orientimin e nxënësve për karrierën. Ky nen thekson detyrimin e drejtorive të shkollave për organizimin e veprimtarive për orientimin e nxënësve për karrierën në klasën e 9-të dhe të 12-të, si dy momente të kalimit të nxënësve nga një nivel në tjetrin apo në tregun e punës dhe arsimimin e mëtejshëm. Vlen të theksohet që rregullorja ndalet vetëm në këto dy momente të shkollimit dhe nuk përcjell detyrime për institucionet arsimore për vitet/klasat e tjera pararendëse. Është e rëndësishme që orientimi i nxënësve për karrierën të fillojë që më herët dhe prandaj është e nevojshme që institucionet arsimore të angazhohen në këtë proces dhe në klasat e mëparshme.**
- Gjithashtu rregullorja përcakton, ndër të tjera, si **detyrë të mësuesit kujdestar të klasës, përkuqdesjen për këshillimin e nxënësve në zgjedhjet kurrikulare dhe zgjedhjet e karrierës.**
- Përsa i takon rolit të shërbimit psiko-social, **urdhri për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet arsimore parauniversitare shprehet në terma të përgjithshëm se shërbimi psiko-social në institucionet arsimore planifikon dhe realizon shërbime që ndihmojnë në zhvillimin arsimor, social dhe personal të nxënësve.** Dokumenti nuk e specifikon në mënyrë të veçantë si një funksion të këtij shërbimi, orientimin dhe këshillim e nxënësve për karrierën.

- **Nga praktikat dhe përvojat e institucioneve arsimore dhe të dhënat e instrumenteve të plotësuar prej tyre,** rezulton se ***në pjesën më të madhe institucionet arsimore janë shprehur se zhvillojnë veprimtari për orientimin e nxënësve për karrierën dhe ofrojnë mbështetje për nxënësit në këtë drejtim.***
- **Lloji i veprimtarive për orientimin për karrierën që zhvillojnë në pjesën më të madhe institucionet arsimore janë bisedat e lira me nxënësit, të cilat janë kryesisht të pastrukturuara.** Gjithashtu, marrja e njohurive përmes lëndëve në tema të caktuara (si kroskurrikul) apo takimet me prindër të profesioneve të ndryshme rezultojnë ndër veprimtaritë që zhvillohen nga një numër më i madh shkollash; **veprimtaritë që zhvillohen nga një numër më i vogël shkollash rezultojnë të jenë këshillimet online dhe panairët e karrierës.**
- Nga të dhënat e ofruara nga institucionet arsimore rezulton se ***drejtuesit e institucioneve arsimore janë personat më të angazhuar për realizimin e veprimtarive për orientimin e nxënësve për karrierën, sikurse dhe mësuesit kujdestarë.*** Këto të dhëna shpjegohen lidhur me faktin se legjislacioni ynë për arsimin përcakton detyrimin e tyre në këtë drejtim. Risjellim në vëmendje faktin që legjislacioni për arsimin bazë dhe për arsimin e mesëm të lartë ngarkon në mënyrë të drejtpërdrejtë drejtorin e institucionit arsimor me detyrën për të organizuar veprimtaritë që mbështesin orientimin e nxënësve për karrierën, në mënyrë të veçantë në klasën e 9-të dhe në klasën e 12-të. **Mësuesi kujdestar** është mësuesi më i angazhuar dhe më pranë nxënësve në lidhje me njohjen e interesave, nevojave, arritjeve, background-it të tyre familjar dhe social. Gjithashtu, legjislacioni për arsimin përcakton në një nen të veçantë detyrimin që ka mësuesi kujdestar për këshillimin e nxënësve në zgjedhjet kurrikulare dhe zgjedhjet e karrierës.
- **Psikologët dhe në mënyrë më të dallueshme punonjësit socialë rezultojnë që angazhohen pak ose jo mjaftueshëm. Nga 805 shkolla, 329 prej tyre janë shprehur se punonjësi social është i angazhuar, pra në më pak se gjysmën e institucioneve arsimore.**

- ***Klasat në të cilat shkollat zhvillojnë më së shumti veprimtari për orientimin për karrierën rezultojnë të jenë klasa 8, 9 dhe 12, si momente të rëndësishme të kapërcimit nga një nivel në tjetrin. Nga përvojat rezulton e nevojshme që elementë të orientimit për karrierën duhet të nisin që në klasat më të ulëta, në mënyrë të veçantë duke filluar nga klasa e 6-të e në vazhdim.***
- ***Shkollat dhe punonjësit arsimorë identifikojnë orët e kujdestarisë dhe përfshirjen në tema të caktuara në lëndë/fusha të ndryshme të të nxënësve të veprimtarive për orientimin për karrierën si format më të përdorura në shkollë për realizimin e orientimit për karrierën. Orët e kujdestarisë sigurojnë hapësirën dhe mundësitë që mësuesi kujdestar të planifikojë dhe të zhvillojë tema të veçanta dhe veprimtari për të realizuar këshillimin e nxënësve për karrierën.***
- ***Pjesa më e madhe e institucioneve arsimore shprehen se këshillimi online për karrierën është një shërbim që pak ofrohet në shkollë, por është shumë i nevojshëm pasi siguron mbështetje për nxënësit, duke mundësuar që nga ky shërbim të përfitojnë një numër më i madh nxënësish.***
- ***Nga të dhënat cilësore rezulton që shkollat e shohin mjaft të nevojshme mbështetjen për zhvillimin profesional të mësuesve, të drejtuesve, të psikologëve dhe punonjësve socialë për orientimin e nxënësve për karrierën. Mbështetja me trajnime dhe materiale burimore deri më tani në këtë drejtim ka qenë e pamjaftueshme.***

4 REKOMANDIME

❖ ***Orientimi i nxënësve për karrierën është një fushë prioritare e përgatitjes dhe formimit të nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar dhe si e tillë duhet të mbështetet dhe të zhvillohet në mënyrë shumëdimensionale.***

❖ ***Institucionet arsimore të arsimit bazë dhe të mesëm të lartë duhet të mundësojnë dhe të sigurojnë zhvillimin e një qasje të kombinuar të edukimit dhe orientimit për karrierën:***

- përmes ***formës kroskurrikulare, duke siguruar përfshirjen në tema/orë të veçanta të lëndëve të ndryshme dhe përmes orëve të kujdestarisë;***

- si ***modul/lëndë e veçantë*** (duke parë dhe mundësinë e përfshirjes së një moduli në klasat 7/8/9 në arsimin bazë);

- përmes ***këshillimeve individuale/grup (të drejtpërdrejta dhe online).***

- përmes ***veprimtarive ekstrakurrikulare dhe në kuadër të veprimtarive të shkollës si qendër komunitare*** të tilla, si takime me përfaqësues të biznesit, me agjenci ose shërbime punësimi; takime me prindër të profesioneve të ndryshme; vizita/biseda në institucione të arsimit të lartë; vizita në vende pune; organizimi i Javës/Ditës së karrierës etj. Në këtë kuadër, mund të shihet dhe mundësia e vendosjes së një mësuesi - koordinator (të specializuar për orientimin për karrierën) në institucionet arsimore parauniversitare, i cili të kujdeset për koordinimin e veprimtarive për orientimin për karrierën. Funkcionimi i këtij roli mund të shihet brenda kuadrit të Shkollës qendër Komunitare, duke përfitur dhe nga ngarkesa e dedikuar shkollave në kuadër të këtij programi.

❖ ***Institucionet arsimore duhet të sigurojnë në mënyrë të veçantë ofrimin e shërbimeve të orientimit për karrierën për grupet vulnerabël/në nevojë*** (si p.sh.,

nxënësit në rrezik braktisje, me vështirësi ekonomike etj.) me qëllim orientimin e tyre drejt ofertave dhe mundësive të arsimimit/formimit/punësimit.

❖ **Prindërit dhe anëtarët e komunitetit**, në mënyrë të veçantë biznesi, agjencitë e punësimit, institucionet e arsimit profesional, universitetet etj., duhet **të afrohen dhe të angazhohen për të qenë bashkautorë në zhvillimin e programeve** të institucioneve arsimore dhe për realizimin e veprimtarive me fokus zhvillimin e aftësive për menaxhimin e karrierës.

❖ **Institucionet e varësisë së MAS, si ASCAP, DPAP, DRAP, ZVAP** duhet të sigurojnë mbështetjen e nevojshme për shkollat përmes **përgatitjes së materialeve burimore dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional të kapaciteteve të stafëve mësimore.**

❖ Institucionet qendrore mund të hartojnë një platformë promovimi për nxënësit e klasës së 9-të dhe të 12-të për t'i orientuar ata lidhur me studimet e mëtejshme dhe me tregun e punës.

Mbështetur në parashtrimet e mësipërme dhe përfundimet e dala si rezultat i kësaj analize rekomandohet:

• **Përgatitja e një kornize (udhëzuesi/programi) që orienton zbatimin e politikave dhe ndërhyrjeve për orientimin e nxënësve për karrierën, në arsimin bazë dhe të mesëm të lartë, në nivel kombëtar, rajonal, lokal dhe institucional.** Ky dokument do të mbështesë shkollat dhe institucionet që koordinojnë dhe monitorojnë punën e tyre në lidhje me:

- fushat prioritare të ndërhyrjeve për orientimin e nxënësve për karrierën;
- planifikimin dhe përfshirjen në planet e veprimtarive të institucioneve arsimore, të llojeve të veprimtarive dhe të shërbimeve që mund të zhvillojnë shkollat për orientimin për karrierën;
- koordinimin e veprimtarive për orientimin për karrierën, në nivel institucioni arsimor, lokal, rajonal dhe kombëtar.

- përfshirjen dhe angazhimin e aktorëve dhe partnerëve në këtë proces;
- identifikimin e burimeve dhe vendosjen e tyre në dispozicion të veprimtarive dhe shërbimeve që i ofrohen nxënësve;
- format dhe mënyrat për monitorimin e vlerësimin e veprimtarive, si edhe në lidhje me
- zhvillimin profesional dhe fuqizimin e kapaciteteve të mësuesve, të drejtuesve, të psikologëve shkollorë dhe të punonjësve socialë.

• **Përgatitja e paketave didaktike (module/materiale ndihmëse për mësuesit kujdestarë, për mësuesit e lëndëve, për psikologët shkollorë, për punonjësit socialë, për mësuesin koordinator të shkollës dhe materiale për nxënësit) për veprimtaritë e orientimit dhe edukimit për karrierën që mund të zhvillohen në shkollë.** Këto paketa mund të përfshijnë modele dhe shembuj veprimtarish për edukimin për karrierën, që mund të zhvillohen nga mësuesit përmes temave të vecanta në lëndë të ndryshme si dhe parashtrime metodologjike për realizimin e tyre; modele veprimtarish për orientimin për karrierën që mund të zhvillohen nga mësuesit kujdestarë në tema të vecanta në orët e kujdestarisë; instrumente të ndryshëm si pyetësorë, teste, intervista të strukturuar etj. të cilat mund të përdoren me nxënësit nga psikologët shkollorë, punonjësit socialë etj.

• **Hartimi i një moduli kurrikular me fokus edukimin për karrierën i cili të ofrohet dhe të zhvillohet në arsimin e mesëm të ulët** (në klasat 7/8/9) si pjesë e kurrikulës në bazë shkolle. Ky modul mund të realizohet dhe konsultohet në bashkëpunim me specialistë të kurrikulës në ASCAP dhe të kërkojë miratimin në MAS.

• Për tema/çështje të veçanta dhe prioritare për kushtet lokale dhe rajonale, mund të **hartohen tema/module të veçantë** të cilët zhvillohen nga shkollat si pjesë e kurrikulës me bazë shkolle, në orët e kujdestarisë.

• Zbatimi i suksesshëm i një qasje të tillë kërkon **përgatitjen e kapaciteteve të mësuesve, të drejtuesve, të psikologëve shkollorë dhe punonjësve socialë, të**

specialistëve të arsimit pranë ZVAP-ve dhe DRAP-ve etj. Në këtë drejtim rekomandohet:

- **Trajnimi i hartuesve të kurrikulës, autorëve të teksteve** për përfshirjen dhe trajtimin e edukimit për karrierën në kurrikul.
 - **Zhvillimi dhe ngritja e kapaciteteve të mësuesve kujdestarë, në mënyrë të veçantë të arsimit të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë,** me qëllim aftësimin teorik dhe praktik të tyre për zhvillimin e veprimtarive që lidhen me edukimin dhe orientimin për karrierën.
 - **Zhvillimi dhe ngritja e kapaciteteve të mësuesve lëndorë, në mënyrë të veçantë të arsimit të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë,** me qëllim aftësimin teorik dhe praktik të tyre për kuptimin e koncepteve që lidhen me edukimin dhe orientimin për karrierën, zhvillimin e veprimtarive kroskurrikulare dhe përdorimin e metodologjive për realizimin e veprimtarive me këtë fokus.
 - **Zhvillimi dhe ngritja e kapaciteteve të mësuesve koordinatorë (nëse do të shihet mundësia e vendosjes së tij)** me qëllim aftësimin teorik dhe praktik të tyre për orientimin dhe këshillimin për karrierën.
 - **Zhvillimi dhe ngritja e kapaciteteve të psikologëve shkollorë dhe punonjësve socialë** me qëllim aftësimin teorik dhe praktik të tyre për orientimin dhe këshillimin për karrierën.
 - **Zhvillimi i kapaciteteve të drejtuesve të institucioneve arsimorë, ZVAP-ve dhe DRAP-ve** për menaxhimin e këtij procesi në nivel shkolle dhe rajoni/qyteti.
 - **Përgatitja e kapaciteteve burimorë (TOT-ve) në çdo ZVAP** për shpërndarjen e trajnimeve me mësues, drejtues dhe grupe të tjerë të interesit.
- **Shkëmbimi i përvojave midis shkollave** përmes workshopeve, takimeve dhe bisedave, zhvillimit të veprimtarive të përbashkëta, panairove të ideve dhe projekteve etj. Për këtë mund të krijohen rrjetet e shkollave, të cilët bashkojnë shkollat e afërta në një lokalitet të

caktuar, ku në mënyrë të vazhdueshme shkëmbehen ide dhe inisiativa të të rinjve që zhvillojnë aftësitë e tyre për menaxhimin e karrierës.

- **Vizita në shkolla të cikleve të ndryshme për të parë nga afër shërbimet që ofrohen në shkolla.**
- **Krijimi i një portali/platforme online** në nivel kombëtar ose rajonal për orientimin për karrierën, përmes të cilit mund të ofrohen informacione për profesionet, për mundësitë e punësimit, për mundësi aplikimesh të ndryshme, modele veprimtarish të shkollave, ide novatore të zhvilluara nga të rinjtë.
- **Përfshirja në kurrikulën e formimit fillestar të mësuesve** e një moduli për orientimin për karrierën do të mundësonte ngritjen e kapaciteteve të studentëve aspirantë për mësues për të përfshirë në kurrikulën ku do të zhvillojnë mësim këtë fushë. Kjo mund të mundësohet përmes ofrimit të materialeve burimorë apo ngritjen e kapaciteteve të pedagogëve që zhvillojnë mësim në nivelin master për mësuesi.
- Ky proces mund të kërkojë apo të ketë nevojë për **një fushatë të gjerë ndërgjegjësimi** me shkollat, me të rinjtë, mësuesit, aktorët dhe partnerët e saj në këtë proces.

5 BIBLIOGRAFIA

- ✧ Assessment report on the current development and challenges that carrier guidance service is facing in Albania, Mirela Andoni, Tiranë 2020.
- ✧ Cedefop (2016), Improving career prospects for the low-educated. The role of guidance and lifelong learning.
- ✧ Cedefop (2016), Labour market information and guidance.
- ✧ Cedefop (2018), Handbook of ICT practices for guidance and career development.
- ✧ Corbanese, V. and G. Rosas (2013), Surfing the labour market: Job search skills for young people. Facilitators' guide and toolkit.
- ✧ Edukimi për karrierën, Libri i mësuesit, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 2011.
- ✧ ETF (2009) In demand: career guidance in EU neighbouring countries.
- ✧ ETF (2011), Career guidance in ETF partner countries – a missing link in the transition from education to the labour market. INFORM Issue 06, Turin.
- ✧ ETF (2014) Career Guidance and VET. A Position Paper, working document, ETF, Turin.
- ✧ Field, S. and Guez, A., (2018) Pathways of progression: linking technical and vocational education and training with post-secondary education.
- ✧ Hansen, E (2006), Career Guidance: A Resource Handbook for Low and Middle Income Countries.
- ✧ Hiebert, B., Borgen, w. A., Schober, K. (2010), Career Development: The Role of Guidance and Counselling in Fostering an Increased Range of Educational and Career Alternatives.
- ✧ Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar, MAS, 2014. <https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2017/03/Korniza-Kurrikulare.pdf>
- ✧ Kurrikulat bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor; për arsimin e mesëm të ulët; për arsimin e mesëm të lartë.
<https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2020/02/Kurrikula-Berthame-per-Klasen-Pergatitore-dhe-Arsimi-Fillor.pdf>
<https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2020/02/Kurrikula-Berthame-6-9.pdf>
<https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2020/02/Kurrikula-Berthame-AML.pdf>
- ✧ Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, Nr.69/2012 i ndryshuar. <https://arsimi.gov.al/ligj-nr-69-2012-per-sistemin-arsimor-parauniversitar-ne-republiken-e-shqiperise-i-azhornuar/>
- ✧ Musset, P. and L. Mytna Kurekova (2018), Working it out: Career Guidance and Employer Engagement.
- ✧ OECD (2004), Career Guidance: A Handbook for Policy Makers.


- ✧ OECD (2010), Learning for Jobs, OECD Reviews of Vocational Education and Training.
- ✧ OECD (2016), Getting Skills Right: Assessing and Anticipating Changing Skill Needs.
- ✧ Programet mësimore të arsimit bazë.
<https://www.ascap.edu.al>
- ✧ Programet mësimore të arsimit të mesëm të lartë.
<https://www.ascap.edu.al>
- ✧ Resolution of the Council and of the Representatives of the Governments of the Member States, meeting within the Council of 21 November 2008 on better integrating lifelong guidance into lifelong learning strategies.
- ✧ Rregullore e funksionimit të Institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, MASR, 2020.
<https://arsimi.gov.al/urdher-nr-31-date-28-01-2020-per-miratimin-e-rregullores-per-funksionimin-e-institucioneve-arsimore-parauniversitare-ne-republiken-e-shqiperise/>
- ✧ UNESCO-UNEVOC (2013), Revisiting Global Trends in TVET.

SHTOJCË

REZULTATET E PYETËSORIT

Tabela 3. Shpërndarja e kampionit pjesëmarrës sipas Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Durrës	276	34,3	34,3	34,3
	Fier	180	22,4	22,4	56,6
	Korçë	235	29,2	29,2	85,8
	Lezhë	114	14,2	14,2	100,0
	Total	805	100,0	100,0	



Grafiku 11. Shpërndarja e kampionit pjesëmarrës sipas Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar

Tabela 4. Shpërndarja e kampionit pjesëmarrës sipas Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Belsh	5	,6	,6	,6
Berat	16	2,0	2,0	2,6
Bulqizë	4	,5	,5	3,1
Cërrik	13	1,6	1,6	4,7
Devoll	2	,2	,2	5,0
Dibër	22	2,7	2,7	7,7
Divjakë	4	,5	,5	8,2
Durrës	53	6,6	6,6	14,8
Elbasan	42	5,2	5,2	20,0
Fier	43	5,3	5,3	25,3

Raport i analizës së orientimit të nxënësve për karrierën në arsimin parauniversitar

Finiq-Dropull	4	,5	,5	25,8
Gramsh	1	,1	,1	26,0
Gjirokastër-Libohovë	13	1,6	1,6	27,6
Has	8	1,0	1,0	28,6
Kamëz	21	2,6	2,6	31,2
Kavajë	10	1,2	1,2	32,4
Klos	5	,6	,6	33,0
Kolonjë	2	,2	,2	33,3
Korçë-Pustec	44	5,5	5,5	38,8
Krujë	13	1,6	1,6	40,4
Kuçovë	17	2,1	2,1	42,5
Kukës	13	1,6	1,6	44,1
Kurbin	4	,5	,5	44,6
Lezhë	28	3,5	3,5	48,1
Librazhd	11	1,4	1,4	49,4
Lushnjë	27	3,4	3,4	52,8
Malësi e Madhe	6	,7	,7	53,5
Maliq	18	2,2	2,2	55,8
Mallakastër	7	,9	,9	56,6
Mat	3	,4	,4	57,0
Mirditë	5	,6	,6	57,6
Patos	4	,5	,5	58,1
Peqin	9	1,1	1,1	59,3
Përmet-Këlcyrë	5	,6	,6	59,9
Pogradec	23	2,9	2,9	62,7
Pukë-Fushë Arrëz	4	,5	,5	63,2
Rrogozhinë	5	,6	,6	63,9
Rroskovec	6	,7	,7	64,6
Sarandë-Delvinë-Konispol	10	1,2	1,2	65,8
Selenicë	14	1,7	1,7	67,6
Skrapar-Poliçan	16	2,0	2,0	69,6
Shijak	13	1,6	1,6	71,2
Shkodër	29	3,6	3,6	74,8
Tepelenë	2	,2	,2	75,0
Tiranë	119	14,8	14,8	89,8
Tropojë	8	1,0	1,0	90,8
Ura Vajgurore	16	2,0	2,0	92,8
Vaudejës	9	1,1	1,1	93,9
Vlorë-Himarë	41	5,1	5,1	99,0

Raport i analizës së orientimit të nxënësve për karrierën në arsimin parauniversitar

Vorë	8	1,0	1,0	100,0
Total	805	100,0	100,0	

Tabela 5. Shpërndarja e shkollave sipas zonës së banimit

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Rurale	459	57,0	57,0	57,0
	Urbane	346	43,0	43,0	100,0
	Total	805	100,0	100,0	

Grafiku 12. Shpërndarja e shkollave sipas zonës së banimit




Tabela 6. Shpërndarja e shkollave sipas profilit/llojit/drejtimit

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Gjimnaz	143	17,8	17,8	17,8
	Shkollë 9-vjeçare (AF+AMU)	494	61,4	61,4	79,1
	Shkollë e arsimit të mesëm të ulët	21	2,6	2,6	81,7
	Shkollë e mesme e bashkuar	138	17,1	17,1	98,9
	Shkollë e mesme me drejtim të orientuar artistik	6	,7	,7	99,6
	Shkollë e mesme me drejtim të orientuar gjuhësor	2	,2	,2	99,9
	Shkollë e mesme me drejtim të orientuar sportiv	1	,1	,1	100,0
	Total	805	100,0	100,0	

Grafiku 13. Shpërndarja e shkollave sipas profilit/llojit/drejtimi




Tabela 7. Shkolla ka një strategji të qartë të orientimit të nxënësve për karrierën (të përcaktuar në planin afatmesëm, vjetor ose në ndonjë plan tjetër të veprimtarive të institucionit arsimor).

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	144	17,9	17,9	17,9
	Po	661	82,1	82,1	100,0
	Total	805	100,0	100,0	

Grafiku 14. Shkolla ka një strategji të qartë të orientimit të nxënësve për karrierën (të përcaktuar në planin afatmesëm, vjetor ose në ndonjë plan tjetër të veprimtarive të institucionit arsimor).

Raport i analizës së orientimit të nxënësve për karrierën në arsimin parauniversitar




Tabela 8. Institucioni juaj arsimor ofron mbështetje dhe organizon veprimtari për edukimin dhe orientimin e nxënësve për karrierën.

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	36	4,5	4,5	4,5
	Po	769	95,5	95,5	100,0
	Total	805	100,0	100,0	

Grafiku 15. Institucioni juaj arsimor ofron mbështetje dhe organizon veprimtari për edukimin dhe orientimin e nxënësve për karrierën.




Tabela 9. Veprimtaritë e të orientimit për karrierën që ju zhvillohen/zbatohen në shkollë

Veprimtaritë	Po	Jo
Marrja e njohurive përmes lëndëve në tema të caktuara.	693	76
Zhvillimi i një moduli për orientimin për karrierën.	394	375
Biseda me nxënës.	761	8
Panaire të karrierës.	322	447
Organizimi i javës/ditës së karrierës.	440	329
Vizita në vende pune.	467	302
Vizita/biseda në institucione të arsimit të lartë (universitete).	368	401
Takime me prindër të profesioneve të ndryshme.	621	148
Takime me përfaqësues të biznesit/anëtarë të tjerë të komunitetit/agjensi ose shërbime punësimi.	480	289
Aktivitete të ndryshme që zhvillojnë sipërmarrjen.	519	250
Këshillim për karrierën (individual dhe/ose në grup).	708	61

Këshillime online.	347	422
--------------------	-----	-----

Grafiku 16. Veprimtaritë e të orientimit për karrierën që ju zhvillohen/zbatohen në shkollë




Tabela 10. Për zhvillimin e veprimtarive të orientimit për karrierën angazhohet më shumë:

Profesioni	Po	Jo
Drejtori i institucionit arsimor	711	94
Nëndrejtori i institucionit arsimor	394	411
Mësuesi kujdestar	766	39
Mësuesi i lëndës	680	125
Psikologu	526	279
Punonjësi social	329	476
Nxënësit	637	168
Prindërit	575	230

Grafiku 17. Për zhvillimin e veprimtarive të orientimit për karrierën angazhohet më shumë:




Tabela 11. Klasa në të cilën zhvillohen më shumë veprimtaritë për orientimin e nxënësve për karrierën.

Klasa	Po	Jo
Klasa I	82	723
Klasa II	79	726
Klasa III	91	714
Klasa IV	119	686

Raport i analizës së orientimit të nxënësve për karrierën në arsimin parauniversitar

Klasa V	217	588
Klasa VI	254	551
Klasa VII	287	518
Klasa VIII	462	343
Klasa IX	671	134
Klasa X	308	497
Klasa XI	375	430
Klasa XII	404	401

Grafiku 18. Klasa në të cilën zhvillohen më shumë veprimtaritë për orientimin e nxënësve për karrierën.




Tabela 12. Veprimtaritë për orientimin e nxënësve për karrierën që zhvillohen në shkollë integrohen me planet për parandalimin e braktisjes së shkollës.

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Aspak	33	4,1	4,1	4,1
	Pak	240	29,8	29,8	33,9
	Plotësisht	532	66,1	66,1	100,0
	Total	805	100,0	100,0	

Grafiku 19. Veprimtaritë për orientimin e nxënësve për karrierën që zhvillohen në shkollë integrohen me planet për parandalimin e braktisjes së shkollës.




Tabela 13. Format e organizimit kurrikular që konsiderohen si forma më të përshtatshme për të realizuar edukimin e nxënësve për karrierën.

Format e organizimit kurrikula	Po	Jo
Forma kroskurrikulare (përmes njohurive në lëndë të ndryshme, si p.sh., në lëndën e Gjuhës Shqipe nxënësit mësojnë të shkruajnë një letër aplikimi për një vend pune).	685	120
Si lëndë/modul i veçantë.	564	241
Përmes veprimtarive ekstrakurrikulare, si p.sh., Java e karrierës etj.	591	214
Përmes veprimtarive në orët e kujdestarisë.	693	112

Grafiku 20. Format e organizimit kurrikular që konsiderohen si forma më të përshtatshme për të realizuar edukimin e nxënësve për karrierën.




Tabela 14. Këshillimi online për karrierën siguron mbështetje për nxënësit, duke mundësuar që nga ky shërbim të përfitojnë një numër më i madh nxënësish.

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Dakord	353	43,9	43,9	43,9
	Neutral	52	6,5	6,5	50,3
	Nuk jam dakord	23	2,9	2,9	53,2
	Pjesërisht dakord	205	25,5	25,5	78,6
	Shumë dakord	172	21,4	21,4	100,0
	Total	805	100,0	100,0	

Grafiku 21. Këshillimi online për karrierën siguron mbështetje për nxënësit, duke mundësuar që nga ky shërbim të përfitojnë një numër më i madh nxënësish.





Tabela 15. Anëtarët e stafit mësimor të shkollës që mund të sigurojnë mbështetje më të kualifikuar për orientimin e nxënësve për karrierën.

Profesioni	Po	Jo
Drejtori	634	171
Nëndrejtori	406	399
Psikologu	560	245
Punonjësi social	423	382
Mësuesi kujdestar	707	98
Mësuesit e lëndëve të ndryshme	575	230
Mësuesi që specializohet për edukimin dhe orientimin për karrierë	720	85

Grafiku 22. Anëtarët e stafit mësimor të shkollës që mund të sigurojnë mbështetje më të kualifikuar për orientimin e nxënësve për karrierën.

Raport i analizës së orientimit të nxënësve për karrierën në arsimin parauniversitar



Tiranë 2022

